


Version pune  
i studimit



# SI DERI NË ARSIMIN E INTEGRUAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË?

2016 Shkup



# SI DERI NË ARSIMIN E INTEGRUAR TË MIRËFILLTË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË?

**AUTORË:**  
**Mr. Bashkim Bakiu**  
**Marija Dimitrovska**  
**Admir Brav**

---

## PROPOZIM POLITIKA PËR ARSIM TË INTEGRUAR

**AUTORË:**  
**Profesor inordiner Dr. Goran Janev**  
**Mr. Sonja Stojadinoviq**  
**Mr. Aneta Smit Guleva**

---

**DISENJI:**  
**Vladimir Gjorgjevski**

**BOTOI:**  
**GAJA DIZAJN**



British Embassy  
Skopje

Ky publikim u mundësua me mbështetjen e Ambasadës së Britanisë në Shkup, në kuadër të Projektit: Dialog për Vizion, i cili u implementua përmes Institutit të Politikave Evropiane. Opinione të prezantuara në këtë publikim janë opinione të autorëve dhe nuk i pasqyrojnë çdoherë opinione të Ambasadës së Britanisë në Shkup.

## PËRMBAJTJA:

### 4. SI DERI NË ARSIMIN E INTEGRUAR TË MIRËFILLTË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË?

4. Abstrakt/Rezime
5. Hyrje
6. Metodologjia dhe qëllimet e hulumtimit
6. Konteksti
7. Inkluzioni dhe integrimi shoqëror në Republikën e Maqedonisë
13. Decentralizimi dhe arsimit
13. Roli i pushtetit lokal në arsimin e integruar në Republikën e Maqedonisë
14. Analiza e të dhënave të fituara nga intervistat e realizuara
15. Intervista me përfaqësues të sektorit të OJQ dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare
17. Intervista me përfaqësues të këshillave prindëror dhe të nxënësve
17. Konkluzione dhe rekomandime
19. Literatura e përdorur
20. Lista e intervistave

### 21. PROPOZIM POLITIKA E ARSIMIT TË INTEGRUAR

21. Rezime/Abstrakt
22. Hyrje
24. Pasqyrë e hulumtimeve dhe praktikave ekzistuese
24. Korniza ligjore për funksionimin e arsimit fillor në RM
24. Analizë: kontrolli gjyqësor ose kontrolli i gjyqësorit
26. Praktika në implementimin e masave të cilat mundësojnë arsim të integruar
29. Dobësi të detektuar gjatë implementimit të Strategjisë
30. Çështje/hipoteza kryesore
31. Metodologjia
31. Analiza
36. Konkluzione
39. Burime të përdorura

# SI DERI NË ARSIMIN E INTEGRUAR TË MIRËFILLTË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË?

Mr. Bashkim Baku, Marija Dimitrovska, Admir Brava

## Abstrakt /Rezime

Integrimi dhe inkluzioni në procesin arsimor u tregua si sfida e madhe e cila duhej të ndihmonte në drejtim të njohjes më të madhe të ndërsjellë midis bashkësive. Megjithatë, për evitimin e situatave konfliktuale ndërmjet nxënësve të grupeve të ndryshme etnike, sistemi arsimor përjetoj segregacion, i cili vite me radhë kishte mbështetje të manifestuar ose latente, me qëllim që të shmangen situata konfliktuale midis nxënësve të grupeve të ndryshme etnike.

Pothuajse një dekadë pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, doli në sipërfaqe dështimi i sistemit arsimor në aspekt të zhvillimit të kohezionit shoqëror midis grupeve të ndryshme kulturore.

Së këtejmi, në fushën e arsimit të integruar, kontributi i organizatave ndërkombëtare është i madh, megjithatë institucionet e pushtetit qendror dhe lokal duhet të krijojnë politika dhe programe në mënyrë që të mundësohet interaksioni pozitiv midis nxënësve të bashkësive të ndryshme ndëretnike.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizohet çka është arritur deri më tani në fushën e integritimit ndëretnik të nxënësve në arsim përmes analizës së studimeve të deritanishme që kanë të bëjnë me këtë çështje dhe përmes hulumtimit direkt në terren me intervista të realizuara me institucione relevante të pushtetit qendror dhe lokal dhe të organizatave joqeveritare.

Fjalët kryesore: integrimi ndëretnik, arsimit i integruar, inkluzioni social.

## Hyrje

Diversiteti kulturor në Republikën e Maqedonisë është sanksionuar në dispozitat themeltare të shtetit, ndërkaq mbrojtja dhe promovimi i tij stimulohet edhe me proceset e integrimit të vendit në Bashkimi Evropian dhe NATO. Respektimi i të drejtave të grupeve të ndryshme etnike garantohet me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë.

Nga këndvështrimi demografik, diversitetet mund të shfrytëzohen si përparësi e Republikës së Maqedonisë. Megjithatë, inkluzioni dhe integrimi shoqëror u treguan si sfida për Republikën e Maqedonisë, e cila edhe pas një dekade të ekzistimit si shtet i pavarur u fut në një konflikt ndëretnik midis dy bashkësive më të mëdha etnike, ndërmjet bashkësisë maqedonase dhe shqiptare, konflikt ky i cili përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe me ndryshime në rregullimin kushtetues dhe legjislacion në aspekt të të drejtave të bashkësive joshumicë në shtet.

Segregacioni në sistemin arsimor vite të tëra ishte më pak ose më shumë i mbështetur në mënyrë transparente, me qëllim që të shmangen situata konfliktuale midis pjesëmarrësve të grupeve të ndryshme etnike. Së këtejmi, si pasojë e këtij segregacioni u shfaq thellimi i dallimeve dhe mbyllja brenda grupeve. Pothuajse një dekadë pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, doli në sipërfaqe dështimi i sistemit arsimor në kontekst të zhvillimit të kohezionit shoqëror midis grupeve të ndryshme kulturore.

Konstatimi paraparak në lidhje me gjendjen konfirmon se arsimit të integruar është temë aktuale për debat publik. Në këtë drejtim, fillimisht u identifikuan politikat dhe projektet e implementuara deri më tani për realizimin e arsimit të integruar. Veç kësaj, u përpilua një pasqyrë e mekanizmave ekzistuese për implementimin e arsimit të integruar, si dhe u analizuan faktorët, përfshirë këtu edhe institucionet nacionale, pushtetin lokal si dhe organizatat ndërkombëtare. Në mënyrë që më lehtë të identifikohen diversitetet dhe ndarjet, si dhe mënyra e implementimit të konceptit të arsimit të integruar, u realizuan intervista me faktorë relevantë të cilët kanë njohuri në këtë fushë. U diskutuan mundësitë e realizimit të arsimit të integruar, roli i pushtetit lokal, roli i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, institucioneve tjera relevante si dhe të organizatave ndërkombëtare.

Në pjesën e fundit të studimit u trajtuan dhe analizuan të dhënat dhe në bazë të kësaj u ofruan rekomandime të caktuara për realizimin e komponentit të arsimit të integruar.

## Metodologjia dhe qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit e nënkupton analizën e realizimit të arsimit të integruar në Republikën e Maqedonisë, faktorët të cilët ndikojnë mbi procesin ose e pamundësojnë zbatimin e tij. Pastaj, hulumtimi bën analizë mbi gjendjen aktuale në domenin e arsimit të integruar, faktorët të cilët kontribuojnë në aspektin e funksionimit, si dhe roli i pushtetit lokal në procesin e decentralizimit.

Në këtë drejtim, hulumtimi në pjesën më të madhe ka të bëjë me projektet dhe me politikat publike të nivelit nacional dhe lokal që ndikojnë mbi realizimin e komponentit të arsimit të integruar.

Pyetje të tjera që u përfshin gjatë realizimit të hulumtimit janë:

- Cilat janë praktikat e deritanishme gjatë implementimit të projekteve në lidhje me arsimin e integruar;
- Me procesin e decentralizimit, a ndikojnë me sukses komunat mbi funksionalitetin e arsimit të integruar;
- Sa kontribuojnë organizatat ndërkombëtare për arsimin e integruar;
- Cilat janë rekomandimet të cilat mund të theksohen për funksionimin më të mirë të arsimit të integruar;

Ky dokument bazohet mbi analizën e dokumenteve, politikave publike dhe hulumtimeve të tjera përmes desk hulumtimit dhe realizimit të intervistave në terren.

Objekt i analizës ishin aktet ligjore dhe nënligjore, marrëveshjet, hulumtimet dhe raportet e organizatave relevante vendore dhe ndërkombëtare, si dhe punimet dhe hulumtimet e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë.

Intervistat u realizuan me përfaqësues të pushtetit lokal të Qytetit të Shkupit, Komunës së Tetovës, Komunës së Kumanovës, Komunës së Tearcës, si dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.

## Konteksti

Arsimi i integruar, përkatësisht sistemi arsimor i cili e mundëson, e kultivon dhe e mbështet inkluzionin dhe interkulturalizmin midis të gjithë pjesëmarrësve, është njëri nga parakushtet themelore për zhvillimin e kohezionit shoqëror dhe parimeve demokratike në shoqëritë multikulturale. Mbrojtja e të drejtave të njeriut, në këtë kontekst edhe të drejtat e minoriteteve, drejtpërsëdrejti ndërlidhet me ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në shtet. Rrjedhimisht me këtë, shtetet e kanë për detyrë t'u sigurojnë pjesëmarrje dhe t'u garantojnë mundësi të barabarta për pjesëmarrje pjesëtarëve të të gjitha minoriteteve në jetën ekonomike, politike dhe sociale në shoqëri. "Integrimi në esencën e vet ka të bëjë me përmbushjen e përgjegjësive të cilat i bartë me vete sovraniteti, përfshirë këtu edhe respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe sigurimin e administrimit të mirë dhe efektiv, ndërkaq i njëjti është i lidhur ngushtë me stabilitetin e përgjithshëm të çdo shoqërie pluraliste" (udhëzime nga Lubjana në lidhje me integrimin e shoqërive me diversitete me arsyetime, viti 2012, f. 3).

Diversiteti kulturor në Republikën e Maqedonisë është sanksionuar në dispozitat themeltare të shtetit, ndërsa mbrojtja dhe promovimi i tij stimulohet edhe me proceset e integritit të vendit në Bashkimin Evropian dhe NATO. Respektimi i të drejtave të grupeve të ndryshme etnike garantohet me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë. Në këtë kontekst, pjesëtarët e bashkësive etnike që nuk janë shumicë kanë të drejtë dhe mundësi që arsimin e tyre ta ndjekin në gjuhën amtare.<sup>1</sup>

Vendet e Ballkanit Perëndimor (përfshirë këtu edhe Republikën e Maqedonisë) i kanë ratifikuar konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve dhe janë në proces të miratimit të legjislacionit. Në vitin 2008, ministrat e arsimit të vendeve të Evropës Juglindore nënshkruan deklaratë të përbashkët në lidhje me përkushtimin ndaj zhvillimit të kapitalit njerëzor në Evropën Juglindore. Kjo deklaratë është “shprehje e përkushtimit ndaj promovimit të: cilësisë, diversitetit dhe qasjes së barabartë në arsim; kapaciteteve në lidhje me inovacionin në sistemin arsimor; dhe kapaciteteve interkulturore të institucioneve arsimore si premisa kryesore për prosperitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe integritimin e tyre në BE” (Spasovski, Ballazhi & Friedman, viti 2010, f. 10). Megjithatë, legjislacioni përkatës vetvetiu nuk mund t’i tejkalojë pengesat në drejtim të inkluzionit dhe integritit shoqëror, meqë duhet t’u përkushtohet vëmendje barrierave strukturore dhe institucionale. Analiza e kornizës ligjore vë në dukje se Kushtetuta dhe ligjet që kanë të bëjnë me arsimin, përmbajnë provizione për promovimin e respektit ndaj kulturave të ndryshme, tolerancës dhe mosdiskriminimit. Megjithatë, fokusi është i orientuar më shumë në drejtim të “parandalimit të praktikave diskriminuese sesa në drejtim të promovimit të këtyre parimeve” (Petroska-Beska, Najcevska, Kenig, Ballazhi & Tomovska, viti 2009, f. 19).

## Inkluzioni dhe integritimi shoqëror në Republikën e Maqedonisë

Inkluzioni dhe integritimi shoqëror u treguan si sfida për Republikën e Maqedonisë, e cila pas ekzistimit prej një dekadë si shtet i pavarur u përball me konflikte etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike, maqedonase dhe shqiptare, i cili përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe me ndryshime në rregullimin kushtetues dhe në legjislacion në kontekst të të drejtave të bashkësive joshumicë në shtet.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit u avancuan disa të drejta të bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në shtet. Në sferën e arsimit, ndryshimet u bënë në aspekt të arsimit të lartë, përkatësisht u parashikua themelimi i arsimit të lartë shtetëror në gjuhën e bashkësisë të cilën e përbëjnë më së paku 20% të popullsisë së përgjithshme. Sa i përket arsimit fillor dhe të mesëm, e drejta e ndjekjes së mësimin në gjuhën amtare, si e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe ligje, rishtas u konfirmua me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Megjithatë, krijimi i institucioneve paralele të arsimit të lartë sipas çelësit gjuhësor/etnik, vetëm i konfirmoi dhe i thelloi ndarjet midis gjeneratave të reja, identiteti nacional i të cilëve u lëkund nga konflikti ushtarak (Barbieri, Vrgova & Bliznakovski, viti 2013).

<sup>1</sup> Amendamenti VIII i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 91 nga data 20.11.2001), viti 2016), neni 3 i Ligjit për arsim fillor (Ligji për arsimin fillor (tekst i konsoliduar), viti 2016), neni 4 i Ligjit për arsimin e mesëm (Ligji për arsimin e mesëm (tekst i konsoliduar), viti 2016) dhe neni 103 i Ligjit për arsimin e lartë (Ligji për arsimin e lartë (tekst i konsoliduar), viti 2016).

Segregacioni në sistemin arsimor, vite me radhë, u manifestua ose në mënyrë latente u mbështet, me qëllim që të shmangen situatat konfliktoze midis pjesëmarrësve të grupeve të ndryshme etnike. Megjithatë, kjo ndarje për rrjedhojë pati përforcimin e stereotipave dhe paragjyqimeve ndaj tjetrit tek të dy grupet më të mëdha etnike. Thua se një dekadë pas miratimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit doli në sipërfaqe dështimi i sistemit arsimor, në kontekst të zhvillimit të kohezionit shoqëror midis grupeve të ndryshme kulturore.

Implementimi i të drejtave të bashkësive, nga ana e faktorëve politikë në shtet, nuk krijoi integrim më të madh. Përkundrazi, u intensifikuan ndarjet etnike, veçanërisht midis të rinjve, ndërsa njohja e tjetrit u bë anekdotike. Ndonëse në nivelin makro, marrëdhëniet ndëretnike përmirësoheshin si rezultat i qasjes institucionale, sa i përket implementimit të Marrëveshjes Kornizë, integrimi i pamjaftueshëm në nivelin individual u shndërrua në një kërcënim afatgjatë sa i përket kohezionit shoqëror (Georgieva, Velkovski & Damovska, viti 2014, f. 128). Në këtë kontekst, është me rëndësi të përmenden rekomandimet e Komisionerit të Lartë për Pakicat Kombëtare, sipas të cilave nevojitet “shmangia e segregacionit në arsim, madje edhe atëherë kur krijohet nga vet bashkësitë e pakicave, së këtejmi duke i respektuar plotësisht të drejtat arsimore të personave të cilët u përkasin pakicave” (Udhëzime nga Lubjana për integrimin e shoqërive diversitare me arsyetime, viti 2012, f. 63).

Ndarja nuk është formale: nxënësit e përkatësive të ndryshme etnike, në kuadër të arsimit fillor dhe të mesëm, mësojnë sipas programeve të ndryshme esenciale mësimore dhe jo vetëm sipas atyre gjuhësore, për lëndë të caktuara (për shembull, histori) të cilat janë kyç për formimin e identitetit të tyre dhe për përkufizimin e raportit të tyre me anëtarët e tjerë të shoqërisë, të përkatësive së njëjtë ose të ndryshme kulturore. Në kuadër të arsimit të lartë, janë formuar institucione paralele arsimore dhe segregacioni plotësisht sipas çelësit etnik.

Në vitin 2008, Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare pranë OSBE paraqiti rekomandime specifike deri te Ministria e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë në lidhje me integrimin përmes arsimit. Rekomandimet vunë në dukje se arsimi i integruar nuk përfundon me vendosjen e fëmijëve, të grupeve të ndryshme etnike, në klasë të njëjtë. Integrimi nënkupton “administrim demokratik dhe të decentralizuar të shkollave; tekste shkollore interesante dhe inkluzive; aktivitete jashtëshkollore dhe decentralizim të programeve mësimore dhe teksteve shkollore, aspekte këto në të cilat Maqedonia shënon ngecje” (Petroska-Beska, Najcevska, Kenig, Ballazhi & Tomovska, viti 2009, f. 21).

Në këtë kontekst, në vitin 2010 Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë nxori konstatimin se edhe krahas progresit të konsiderueshëm në fushën e arsimit, gjatë dekadës së kaluar, në sferën e arsimit në gjuhën amtare nevojitet të korrigjohen drejtimit e zhvillimit, në mënyrë që të shmangët rritja e ndarjeve etnike, të mbështetura nga mosnjohja e mjaftueshme e tjetrit dhe interaksionit të reduktuar, si pasojë e mosnjohjes së gjuhës së tjetrit. Për shkak të moshës së re të zhvillimit të vetëdijes për tjetrin, shkollat kanë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në drejtim të kultivimit të ndjenjave pozitive dhe mirëkuptimit midis bashkësive të ndryshme etnike (Shustereder dhe Simonovska-Janaçkovska, viti 2010).

Me ndihmën e Komisionerit të Lartë për Pakicat Kombëtare pranë OSBE, në muajin janar të vitit 2010, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe OSBE e miratuan dokumentin strategjik: “Hapa drejt arsimit të integruar në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë” (viti 2010), me qëllim që të inkorporohen ndryshime të qarta dhe drastike në qasjen e përgjithshme në sistemin arsimor, në kontekst të realitetit multietnik të shoqërisë. Ky dokument paraqet pikënisje kyç sa u përket masave që kanë të bëjnë me arsimin e integruar.



Masat e parapara me Strategjinë parashikojnë reforma dhe aktivitete në pesë fusha të veprimit: integrim përmes aktiviteteve të nxënësve jashtë procesit mësimor; rritja e njohjes së ndërsjellë të gjuhëve tek nxënësit dhe të rriturit; përshtatje të planeve dhe programeve mësimore dhe teksteve shkollore (me theks të veçantë mbi tekstet shkollore të Historisë, Gjeografisë dhe teksteve shkollore për mësimin e gjuhëve, si dhe inkorporimi i lëndës Historia e religjioneve); trajnim i mësimdhënësve për t'u përballur me çështjet ndëretnike; dhe administrimi i shkollave në kontekstin e decentralizimit (Hapa drejt arsimit të integruar në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë, viti 2010). Drejtoria për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive, si dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit duhet të marrin pjesë në të gjitha hapat e parapara me Strategjinë (Plani Strategjik i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës viti 2015-2017, 2014). Së këtejmi, duhet të theksohet se Strategjia fillimisht është fokusuar mbi rolin e arsimit fillor dhe të mesëm në proceset e rritjes së kohezionit shoqëror midis grupeve të ndryshme kulturore, me ç'rast dokumenti nuk i përcakton kurrfarë roli arsimit të lartë, si faktor për arsimin e integruar. Presionet e fuqishme politike, sa i përket implementimit të reformave të caktuara në arsimin fillor (në lidhje me mësimin e gjuhës maqedonase për nxënësit të cilët procesin mësimor e ndjekin në gjuhë tjetër) proceset e reformave të parapara me Strategjinë i vuri në plan të dytë, ndërsa nuk janë parashikuar nisma të reja në Planin e ri Strategjik 2015-2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, viti 2014).

Hulumtimi i gjendjeve në fushën e integritimit ndëretnik nga viti 2012, zbatuar nga Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe për Zgjidhjen e Konfliktëve, në bashkëpunim me Qendrën Maqedonase për Arsim Qytetar dhe me Byronë e Zhvillimit të Arsimit, konstatoi se rreth një e katërta e shkollave filllore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë janë dygjuhësore ose trigjuhësore. Një numër i madh i shkollave filllore, të cilat zyrtarisht konsiderohen si shkolla dygjuhësore ose trigjuhësore nuk e mundësojnë kontaktin e drejtpërdrejtë midis nxënësve të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Vetëm 13% e shkollave sigurojnë në të gjitha vitet shkollore, nën kulm të njëjtë, të mësojnë nxënës nga të gjitha gjuhët mësimore të përfaqësuara në shkollë (Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe për Zgjidhjen e Konfliktëve, viti 2012, f. 14). Gjatë dekadës së kaluar, numri i shkollave shumëgjuhëshe në Republikën e Maqedonisë u reduktua nga 72 në 63 (Petroska-Beska, Najcevska, Kenig, Ballazhi & Tomovska, viti 2009, f. 7). Ikonografia multikulturore nuk është dukuri e shpeshtë nëpër shkolla, ndërsa nëse e njëjta është e pranishme, atëherë kryesisht më së shpeshti mbështetet në gjuhën e bashkësisë etnike për të cilën ka të bëjë, e që nuk kontribuon për krijimin e një atmosfere përkatëse të ndërtimit të multikulturalizmit në nivel të shkollës. Është konstatuar se në shkollat me numër të konsiderueshëm të nxënësve romë, nuk ndërmerren çdoherë aktivitete për lehtësimin e integritimit të tyre në shkollë dhe më së shpeshti mungon ikonografia e rëndësishme për identitetin etnik të romëve. Bashkëpunimi ndërshkollor, i cili është më intensiv në nivel të shkollave filllore, kryesisht zhvillohet midis shkollave me gjuhë të njëjtë mësimore. Në numrin më të madh të shkollave shumëgjuhëshe, nuk ka orë të përbashkëta në asnjë lëndë. Në ato shkolla, në të cilat ka kjo më së shpeshti ndodhë në lëndën e edukatës fizike (Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe për Zgjidhjen e Konfliktëve, viti, 2012).

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e mësimdhënësve nuk janë të përgatitur në mënyrë përkatëse që të punojnë me fëmijë dhe prindër me prejardhje të ndryshme sociale dhe kulturore. Një numër i madh i hulumtimeve e konfirmuan ekzistimin e nevojës për kompetenca të rritura tek mësimdhënësit sa i përket identifikimit, pranimit dhe vlerësimit të diversitetit në klasë dhe në shoqërinë më të gjerë, si dhe nevojën që të punohet në zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve për tejkalimin e diskriminimit, përjashtimit dhe padrejtësive në arsim.

Analiza e planeve dhe programeve mësimore, lidhur me arsimin e reformuar fillor nëntëvjeçar, vuri në dukje se ato paraqesin bazë përkatëse për implementimin dhe promovimin e multikulturalizmit në shkolla (Petroska-Beska, Najcevska, Kenig, Ballazhi & Tomovska, viti 2009). Progresi e ngërthen në vetvete edhe inkorporimin e gjuhës maqedonase për bashkësitë e tjera nga klasa e parë;<sup>2</sup> megjithatë, inkorporimi i gjuhëve lokale për nxënësit maqedonas është i kufizuar.<sup>3</sup> Së këtejmi, inkorporimi i gjuhës maqedonase, si gjuhë e detyrueshme nga klasa e parë për nxënësit të cilët mësimin e ndjekin në gjuhë tjetër, hasi në presion të fuqishëm politik nga blloku politik shqiptar dhe e njëjta nuk u zbatua, e që e vuri në pikëpyetje implementimin e masave të tjera reformuese të Strategjisë së Arsimit të Integruar.

Programet mësimore, veçanërisht lëndët e arsimit për aftësi jetësore dhe lëndët zgjedhore, përmbajnë objektiva arsimore të cilat e promovojnë multikulturalizmin dhe respektin ndaj diversiteteve kulturore/etnike. Probleme më të mëdha hasen në lëndën e Historisë, me ç'rast mësimi i historisë të grupeve tjera etnike kryesisht varet nga dëshira e mësimdhënësit. Tekstet shkollore e mbështesin etnocentrizmin. Marrë në përgjithësi, mungojnë përmbajtje, personalitete, fotografi ose autorë me të cilat nxënësit do të njoftohen me kulturën dhe traditën e bashkësive të tjera etnike, si dhe do ta zhvillojnë mirëkuptimin për vlerat e dyanshme (Petroska-Beska, Najcevska, Kenig, Ballazhi & Tomovska, viti 2009).

Shkollave u mungojnë kapacitete për zgjidhjen konstruktive të konflikteve. Organizatat e nxënësve, nga aspekti formal, ekzistojnë por roli i tyre është marginal, nuk marrin pjesë në procesin e miratimit të vendimeve dhe as në dialogun interetnik.

Analiza e manualeve për realizimin e procesit mësimor në disa lëndë zgjedhore vuri në dukje se tek lëndët: Hulumtimi i vendlindjes, Atdheu ynë, Valle dhe vallëzime popullore (Janevski, Iliq dhe Vitanova, viti 2008; Apostollovska-Toshevska dhe Jurukov, viti 2008; Brashnarska dhe Gievski, viti 2008), mungojnë udhëzime për promovimin e multikulturalizmit dhe njohjen, respektimin dhe vlerësimin e diversiteteve kulturore dhe kontributin e tyre në drejtim të identitetit kombëtar.

Marrë në përgjithësi, tekstet shkollore mbështesin qëndrim etnocentrik, në vend që të sigurojnë një bazament për identitetin e përbashkët qytetar dhe nacional. Në një numër të madh të rasteve, tekstet shkollore kontribuojnë në drejtim të zhvillimit të identiteteve të segreguara etnike (Petroska-Beska, Najcevska, Kenig, Ballazhi & Tomovska, viti 2009).

<sup>2</sup>Nga viti shkollor 2009/2010, u parashikua që gjuha maqedonase të jetë gjuhë e detyrueshme mësimore nga klasa e parë e arsimit fillor (si edhe gjuha angleze) për nxënësit të cilët procesin mësimor e ndjekin në gjuhë tjetër. Nga pavarësimi e deri më sot, kjo lëndë mësohet nga klasa e katërt.

<sup>3</sup>Nxënësit, të cilët procesin mësimor e ndjekin në gjuhën maqedonase kanë mundësi të bëjnë zgjedhjen e mësimit të gjuhës shqipe si lëndë zgjedhore; lëndë zgjedhore janë edhe lëndët: gjuha dhe kultura e vllahve, gjuha dhe kultura e romëve dhe gjuha dhe kultura e boshnjakëve.

Problemet në fushën e integritimit arsimor, sipas analizave të Georgieva, Vasilevski dhe Damovska, para së gjithash, kanë të bëjnë me:

1. Vendosijen e sistemeve paralele arsimore, të cilët kontribuan për distancën hapësinore;
2. Prezantimin faktografik i elementeve tradicionale të kulturave të tjera në tekstet shkollore dhe në procesin e mësimi; theksi vihet mbi akvizionin kognitiv, me ç'rast mungojnë proceset e mirëkuptimit, vlerësimit dhe respektimit;
3. Mungesën e aktiviteteve shkollore dhe aktiviteteve jashtëshkollore në të cilat marrin pjesë të rinjtë e kulturave të ndryshme. Deri më tani janë bërë përpjekje minimale për përmirësimin e këtyre gjendjeve nga ana e institucioneve shtetërore;
4. Mungesën e kompetencave për arsim interkulturore tek kadri mësimor. Për një gjendje të këtillë kontribuon edhe rigjediteti i akteve dhe standardeve normative të cilat e rregullojnë arsimin dhe planet e programet mësimore, të cilat rrallëherë orientohen në drejtim të përvetësimit, promovimit dhe zhvillimit të aftësive interkulturore;
5. Ndikimin e fuqishëm të kanaleve joformale dhe formale të arsimit (familja, bashkësia lokale, komuniteti fetar, mediat, partitë politike);
6. Mungesën e objektivave qartë të përkufizuara nacionale dhe lokale të arsimit. Në këtë drejtim (keq) përdorimi i arsimit për fuqizimin e etnocentrizmit, në të ardhmen, mund të rezultojë me implikime të shumta negative;
7. Strukturat politike në praktikë nuk i konfirmojnë objektivat e deklaruarin inherente të rregullimit pedagogjik dhe arsimit në tërësi (Georgieva, Velkovski & Damovska, viti 2014, f. 128-129).

Kur bëhet fjalë për masat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me promovimin e arsimit të integruar në Republikën e Maqedonisë, pavarësisht Strategjisë së miratuar nga ana e ministrisë kompetente, duhet të nënvizohet se pjesa më e madhe e nismave, në lidhje me këtë problem, burojnë nga aktivitetet e përbashkëta të organizatave ndërkombëtare dhe organizatave qytetare, ndërsa përkushtimi i institucioneve të sistemit është papërfillshëm. Në Progres Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë lidhur me proceset eurointegruese nga viti 2015, rekomandohet zbatimi i evaluimit të implementimit të reformave të zbatuara në dhjetë vitet e fundit, si dhe theksohet nevoja e formulimit të planit të ri strategjik “me korrelacion të qartë midis të gjitha proceseve reformuese dhe palëve të interesit” (European Commission, viti 2015, f. 66). Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Planin Strategjik për Punë për periudhën kohore 2015-2017, nuk parashikon programe të cilët drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me proceset e arsimit të integruar. Ndikim të tërthortë mund të kenë programet e arsimit inkluziv të grupeve të marginalizuara (para së gjithash, në kuadër të Programit Dekada e Romëve) dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe përmes zhvillimit dhe mbështetjes së proceseve të decentralizimit në sistemin arsimor (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, viti 2014, f. 66).

Në aspekt të iniciativave, nga ana e institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave qytetare, si substitut i llojit të vet për moratoriumin e reformave të Strategjisë për Arsimin e Integruar, viteve të fundit janë realizuar më shumë studime, projekte dhe aktivitete të tjera. Në periudhën kohore nga viti 2011 deri në vitin 2015, USAID e realizoi Projektin: “Projekt për integrimin ndëretnik në sistemin arsimor”, në bashkëpunim me institucionet kryesore arsimore dhe komunat, si dhe me partnerë nga sektori civil. Nga Projekti kanë rezultuar disa studime të rastit për më shumë shkolla të mesme në Shkup dhe në qytete të tjera të Republikës së Maqedonisë. Analizat në terren paraqesin një bazë të frytshme për përpilimin e disa manualeve, në lidhje me aspektet e ndryshme të arsimit të integruar (aktivitete të përbashkëta në grupe me përbërje të përzier etnike/gjuhësore, pjesëmarrje demokratike të nxënësve, etj.), udhëzues dhe trajnime për integrimin multietnik në shkolla.

Në periudhën kohore nga viti 2012-2013, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me mbështetje të Ambasadës së Norvegjisë e realizoi Projektin: “Mësojmë së bashku”, i cili u fokusua mbi integrimin e nxënësve me kultura të ndryshme përmes aktiviteteve jashtë procesit mësimor dhe përfshiu 70 shkolla në 25 komuna (janë prezantuar një pjesë e aktiviteteve të Projektit për arsimin e integruar “Mësojmë së bashku”, viti 2012).

Në dhjetor të vitit 2013, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë (BNJVL) organizuan një sesion pune për personat përgjegjës në arsim nga njësitë e vetëqeverisjes lokale me titull: “Koncepte dhe praktika të arsimit të integruar në Republikën e Maqedonisë” (Koncepte dhe praktika të arsimit të integruar, viti 2013).

Në vitin 2013 u mbajt Konferenca e dytë ndërkombëtare përkushtuar arsimit të integruar, me titull: “Arsimi i integruar – trend, tendencë dhe nevojë”, në organizim të Qendrës për Dialog Nansen Shkup. U zbatuan trajnime, për rreth nëntëdhjetë profesorë, sa i përket implementimit të parimeve të arsimit të integruar në procesin mësimor. Njëri nga konkluzionet e Konferencës iu dedikua segregacionit etnik në rritje në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë, si faktor i cili kontribuon në drejtim të mostolerancës etnike dhe distancës midis të rinjve (Konferencë për arsimin e integruar për tejkalimin e ndarjeve etnike në shkolla, viti 2013). Në fillim të muajit janar të vitit 2015, filloi të funksionojë Fondacioni për Arsimin e Integruar (Fondacioni për Arsimin e Integruar e mbajti takimin e parë të Këshillit Drejtues, në vitin 2015)

Të gjitha iniciativat e deritanishme e identifikuan arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm si fusha kryesore për iniciimin e proceseve të përafrimit të bashkësive etnike. Duhet të theksohet se mungojnë iniciativa për integrimin arsimor në kuadër të arsimit të lartë. Kjo e dhënë është shqetësuese, nëse e kemi parasysh faktin se segregimi etnik në arsimin e lartë mund t'i rrënojë efektet pozitive të arritura në arsimin fillor dhe të mesëm. Problemi i rolit të arsimit të lartë në shoqërinë multietnike maqedonase është si rezultat i kontekstit më të gjerë të marrëdhënieve ndëretnike, veçanërisht si problem i qasjes në arsimin e lartë të grupeve joshumicë. Kjo u shndërrua në një aspekt mjaft të shprehur të tensioneve ndëretnike, ashtu siç u politizua qasja në arsimin e lartë (Georgieva, Velkovski & Damovska, viti 2014).

Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Planin e ri Strategjik parashikon disa masa të cilat në mënyrë të tërthortë mund të kontribuojnë në drejtim të gjendjeve në fushën e arsimit të integruar. Së këtejmi, është planifikuar inkorporimi i gjuhëve të bashkësive si lëndë zgjedhore në fakultetet pedagogjike dhe në Fakultetin Filologjik në Shkup, si dhe inkorporimi i kuotave për regjistrimin e pjesëtarëve të bashkësive etnike me numër më të vogël (Plani Strategjik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, viti 2015-2017, 2014, f. 64-65). Edhe pse këto masa në mënyrë të tërthortë mund të kontribuojnë në drejtim të integritit të pjesëtarëve të bashkësive më të vogla etnike, nuk pritet të arrihen rezultate të rëndësishme në planin e përafrimit të maqedonasve dhe shqiptarëve, të cilët në kuadër të arsimit të lartë janë plotësisht të segreguar në universitete sipas çelësit gjuhësor/etnik, në mesin e të cilëve mungon çdo lloj bashkëpunimi. Një lloj integrimi ka në fushën e ciklit të tretë të studimeve, por ai është pragmatik dhe formal dhe nuk e nënkupton shprehjen e përafrimit thelbësor të të dyja bashkësive.

Gjatë krijimit të strategjive për integrimin e arsimit të lartë, është me rëndësi që institucionet e fushës së arsimit të lartë, me theks të veçantë mbi praktikatat pozitive (kampuse mikse, aksesit i kurseve në disa gjuhë, aktivitete plotësuese, etj.), t'i kuptojnë kufizimet e konceptit të arsimit të integruar dhe ta stimulojnë "ripërkufizimin e konceptit të arsimit të lartë, i cili është më gjithëpërfshirës, inkluziv dhe human dhe i përfshin nevojat e shoqërisë më të gjerë, në vend që të fokusohet mbi përmbushjen e nevojave të grupeve të veçanta etnike" (Georgieva, Velkovski & Damovska, viti 2014, f. 134).

## Decentralizimi dhe arsimit

### Roli i pushtetit lokal në arsimin e integruar në Republikën e Maqedonisë

Me procesin e decentralizimit, komunave iu deleguan një sërë obligime dhe kompetenca, duke e përafruar pushtetin më afër qytetarëve.

Duke e pasur në konsideratë se arsimit është një segment i rëndësishëm në zhvillimin e një shoqërie, nga kjo mund të nxjerrim një konstatim logjik se procesi i decentralizimit komunat i vë në pozitë të protagonistëve kryesorë në realizimin e konceptit të arsimit të integruar.

Kur bëhet fjalë për rëndësinë e pushtetit lokal në procesin e arsimit të integruar, një fakt plotësues është argumenti se komunat janë përgjegjëse për themelimin, financimin dhe administrimin e shkollave fillore dhe të mesme (Ligji për vetëqeverisjen lokale, viti 2002). Pastaj, subjekte të rëndësishme në nivel lokal, krahas administratës komunale, janë drejtorët, këshilli i shkollës, këshilli i mësimdhënësve, këshilli i prindërve dhe pala kryesore e prekur - nxënësit. Në këtë drejtim, decentralizimi e nënkupton edhe stimulimin e qytetarëve që të përfshihen në mënyrë më aktive në proceset e miratimit të vendimeve në disa fusha, përfshirë këtu edhe arsimin. Të gjithë këto komponentë janë jashtëzakonisht të rëndësishëm për realizimin e konceptit të arsimit të integruar, veçanërisht në komunat me strukturë heterogjene etnike.

Megjithatë, nga ana tjetër, përkrah asaj që arsimit të integruar paraqet tendencë globale, në Republikën e Maqedonisë ky koncept perceptohet si utopist. Analizat e deritanishme vunë në dukje se të gjitha përpjekjet paraprake, të zbatuara në këtë drejtim, janë iniciuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pa analizë paraprake përkatëse dhe konsulta me "realizuesit", përkatësisht komunat, të cilat kanë njohuri të thella lidhur me situatat në terren.

Në të vërtetë, me shmangien e qasjes „bottom up“, ekziston rrezik që kjo komponent të shndërrohet në çështje politike. Në këtë drejtim shkonte edhe përpjekja e MASH-it që ta implementojë dispozitën për mësimin e detyrueshëm të gjuhës maqedonase nga klasa e parë për nxënësit, të cilët mësimin e ndjekin në gjuhë tjetër, e që hasi në presione nga blloku politik shqiptar dhe si pasojë u vu në pikëpyetje implementimi edhe i masave të tjera reformuese të Strategjisë për Arsimin e Integruar.

Konstatimi, në kuadër të kësaj analize në lidhje me atë se segregacioni në sistemin arsimor, vite të tëra, kishte përkrahje me qëllim që të evitohen situatat konfliktuale midis nxënësve të grupeve të ndryshme etnike, shpie në konkluzionin për krizën në rritje lidhur me tentativat për integrim si dhe vë në dukje çështjen kryesore si të arrihet integrimi në kushte të mungesës së komunikimit.

Së këtejmi, përvojat e deritanishme të fituara në procesin e realizimit të aktiviteteve në kuadër të arsimit të integruar realizohen në nivel të projektit, ndërsa të njëjtat përfundojnë me përfundimin e projekteve. Ky konstatim u konfirmua edhe përmes realizimit të intervistave në komunat e përfshira me këtë projekt.

Nga ana tjetër, mjetet financiare u treguan si faktor kyç për realizimin e aktiviteteve në lidhje me arsimin e integruar. Komunat nuk kanë zë të veçantë financiar për arsimin e integruar. Kur bëhet fjalë për decentralizimin, ky proces është përcjellë me inkorporimin e mekanizmave për financimin e komunave, që nënkupton shpërndarje të mjeteve me dedikim dhe përmes bllok dotacioneve, të cilat komunat i përdorin për aktivitete në kompetencë të tyre. Megjithatë, gjatë përgatitjes së formulës për bllok dotacione dhe përmes intervistave të realizuara për nevojat e këtij projekti, u konfirmua se nuk ekziston "koeficient" i veçantë për arsimin e integruar, ndërsa komunat nuk kanë mundësi të kontribuojnë financiarisht në këtë segment.

## Analiza e të dhënave të fituara nga intervistat e realizuara

Analiza e të dhënave nga intervistat e realizuara me përfaqësuesit e pushtetit lokal vënë në dukje se realizimi i aktiviteteve, të cilat kanë të bëjnë me arsimin e integruar janë në nivel të projektit, ndërsa komunat paraqiten si realizuese sipas urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Megjithatë, pjesëmarrësit prezantuan disa perceptime, të cilat mund të kontribuojnë në drejtim të funksionimit të arsimit të integruar, të cilat kanë të bëjnë me mungesën e mjeteve financiare për implementimin e arsimit të integruar. Kur bëhet fjalë për shpërndarjen e financave deri te komunat nga ana e pushtetit qendror, të njëjtat realizohen përmes "bllok dotacioneve" për të cilat nuk ekziston zë i veçantë në kuadër të buxhetit për arsim, përkatësisht mjetet që do të dedikohen ekskluzivisht për zhvillimin ose zbatimin e komponentit arsim i integruar. Më së shpeshti, në praktikat e deritanishme për zbatimin e projekteve ose aktiviteteve të këtilla, komunat mjetet i kanë siguruar nga buxheti të dedikuara për aktivitetet e sektorit joqeveritar ose përmes bashkëpunimit me donatorë ndërkombëtarë. Në këtë drejtim, pjesëmarrësit e e vunë në dukje nevojën e inkorporimit të koeficientit të veçantë të dedikuar për arsimin e integruar, me ç'rast do të rritej përgjegjësia e autoriteteve lokale në drejtim të realizimit dhe ndërmarrjes së aktiviteteve konkrete në fushën e arsimit të integruar.

Mendimet e të anketuarve, në lidhje me iniciativat për realizimin e projekteve të përbashkëta që kanë të bëjnë me arsimin e integruar ndëretnik, vënë në dukje se ata çdoherë janë iniciuar dhe mbështetur nga ana e donatorëve ndërkombëtarë, ndërsa nga ana tjetër, të dhënat shqetësuese kanë të bëjnë me mungesën e disa shkollave gjatë implementimit të këtyre projekteve (përfaqësues nga komuna e Kumanovës). Një shembull të ngjashëm e vunë në pah edhe përfaqësuesit e komunës së Tearcës në lidhje me problemin e promovimit të integritit multi-etnik në sistemin arsimor.

Edhe pse Tearca si komunë në programin e saj e ka miratuar Projektin e arsimit ndëretnik, megjithatë deri më tani vetëm një herë është iniciuar socializimi midis nxënësve, me ç'rast nuk ka pasur jehonë nga ana e nxënësve të të gjitha bashkësive etnike. Angazhimet dhe aktivitetet e tjera janë zbatuar me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë (USAID, OSBE).

Bashkëpunimin me donatorët, përfaqësuesit e pushtetit lokal e vlerësojnë pozitivisht në realizimin e projekteve të këtilla, megjithatë vënë në dukje se të gjitha palët duhet të involvohen për njohje të ndërsjellë, duke i theksuar mediat dhe partitë politike të cilat kanë ndikim të madh në marrëdhëniet ndëretnike në nivel lokal.

Pastaj, përfaqësuesit e pushtetit lokal vunë në dukje se problemet financiare, me të cilat përballen komunat, paraqesin pengesë serioze që kjo politikë të bëhet permanente. Sipas numrit më të madh të pjesëmarrësve, aktivitetet e deritanishme, në lidhje me këtë temë, pa marrë parasysh nëse janë realizuar në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ose me organizata vendore ose ndërkombëtare, janë ndërprerë me përfundimin e projektit.

Një mungesë tjetër që u theksua gjatë realizimit të intervistave është mungesa e një sektori të veçantë për arsimin e integruar në kuadër të bartësit kryesor të politikës arsimore, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Nga ana tjetër, komunat, veçanërisht ato me përbërje etnike heterogjene, kanë kapacitete të vogla për menaxhimin e aktiviteteve lidhur me arsimin e integruar ose janë preokupuar me aktivitete tjera të cilat u imponohen në kuadër të sektorit të arsimit në pushtetin lokal.

Mes tjerash, përfaqësuesit e pushtetit lokal e vunë në dukje mbështetjen operative dhe sistematike gjatë implementimit të arsimit të integruar, ndërsa theksuan se krahas angazhimeve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet t'u ofrojë udhëzime të qarta për realizim, duke theksuar se iniciativat duhet të burojnë nga shkollat dhe nga komunat, dhe jo si projekte nga organizata joqeveritare të cilat si të këtilla, megjithatë, japin kontribut pozitiv.

---

## **Intervista me përfaqësues të sektorit të OJQ dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare**

---

Analiza e të dhënave të fituara nga intervistat e realizuara me përfaqësuesit e OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare në lidhje me arsimin e integruar, vë në pah perspektiva të ndryshme për realizimin dhe funksionimin e arsimit të integruar. Ato nënvizojnë se implementimi i projekteve të këtilla ka nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse dhe punë jo vetëm me nxënësit por edhe me publikun e gjerë, duke theksuar se krahas institucioneve, faktorë relevantë janë edhe prindërit, pastaj mësimdhënësit, partitë politike, mediat dhe protagonistët kryesorë të tjerë, me qëllim që të arrihet interesi dhe vullneti i përbashkët. Sa u përket financave, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, po ashtu e theksojnë problemin me mungesën e mjeteve financiare nga ana e komunave për realizimin dhe implementimin e arsimit të integruar. Pjesëmarrësit prezantuan shembuj pozitiv të realizimit të aktiviteteve në të cilët si partnerë janë imponuar komunat (bashkëpunimi i Qendrës për Dialog Nansen Shkup nga Norvegjia me komunën e: Strumicës, Gjorçe Petrovit, Konçës, Karbincës, Tetovës dhe Çairit).

Marrë në përgjithësi, ekziston pajtim midis përfaqësuesve të OJQ-ve dhe pushtetit lokal dhe qendror për atë se partitë politike janë faktorë relevantë dhe mund të kontribuojë shumë në aspekt të arsimit të integruar. Sipas përfaqësuesit të Qendrës për Dialog Nansen Shkup nga Norvegjia, kjo organizatë në kontinuitet punon në Republikën e Maqedonisë në drejtim të implementimit të konceptit të arsimit të integruar. Ai theksoi disa shembuj të praktikave të mira dhe punës me prindër dhe me liderë lokalë, duke e apostrofuar shembullin në komunën e Jegunovcit.

Qendra për Dialog Nansen Shkup, në kuadër të programit të saj e zhvillon edhe modelin e arsimit të integruar, vizion i së cilës është “modeli arsimor i cili i kultivon, stimulon dhe i integron vlerat multietnike, dygjuhësinë dhe i promovon e i mbështet raportet e partneritetit midis nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve, e stimulon përfshirjen e bashkësive përmes vendosjes së marrëdhënieve harmonike, të cilat themelohen në respektimin e diversiteteve”. Lidhur me këtë Program, përfaqësuesi i Qendrës për Dialog Nansen Shkup vuri në pah se në kuadër të këtij modeli funksionojnë programet për nxënës, për prindër dhe programi për mësimdhënës. Pastaj, thotë se përmes këtij Programi investohet në shkollat në të cilat përmirësohen kushtet e punës, transformohen në shkolla multifunksionale, me qëllim që të ketë proces mësimor cilësor dhe të rregullt dhe aktivitete jashtë procesit mësimor, në mënyrë që të iniciohet komunikim më i mirë midis kuadrit të shkollës dhe prindërve.

Më tutje, në kuadër të programeve të Qendrës për Dialog Nansen Shkup ekziston edhe qendra e trajnimit, e cila ofron trajnim praktik për modelin Nansen të arsimit të integruar, përkushtimi i së cilës është të siguroj zhvillim profesional të mësimdhënësve, profesorëve, pedagogëve, psikologëve, inspektorëve të arsimit dhe udhëheqësve të shkollave.

Edhe Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar (QMAQ) është organizatë, misioni i së cilës është të hartojë programe arsimore dhe t'u sigurojë shërbime institucioneve arsimore dhe institucioneve të tjera publike. Nga ekzistimi i deritanishëm, kanë implementuar një numër të madh të projekteve, të cilët drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me arsimin e integruar. Përfaqësuesi i QMAQ vuri në dukje se punojnë në dy drejtime edhe me shkollat edhe me institucionet dhe, sipas tij, qasja e këtillë është e domosdoshme për shkak se kërkon pëlqim nga anë të ndryshme. Pozitivisht vlerësohet edhe bashkëpunimi me institucionet nacionale kompetente për implementimin e arsimit të integruar, njëkohësisht edhe aktivitetet e deritanishme në kuadër të projekteve të realizuara me komunat. Sipas tij, sfidat janë të përditshme, ndërsa pyetjes se si e percepton arsimin e integruar pas disa vitesh, përfaqësuesi i QMAQ vuri në dukje se arsimin e integruar e percepton si proces i cili ka mbështetje nga shteti, komunat, mediat dhe nga mbarë shoqëria, duke nënvizuar se procesi kërkon mbështetje nga të gjitha palët.

Arritje e madhe e QMAQ është fakti se Projekti për Integrim Ndëretnik në Arsim imponohet si politikë e institucioneve, e që nënkupton se kjo politikë do të mbështetet edhe më tutje.



## Intervista me përfaqësues të këshillave prindëror dhe të nxënësve

Pasqyra e opinioneve të përfaqësuesve të këshillave të prindërve dhe të nxënësve, në lidhje me arsimin e integruar, tregon gatishmëri për bashkëpunim dhe zhvillim të çdo lloj aktiviteti që ka të bëjë me arsimin e integruar.

Sa u përket prindërve, përfaqësuesi i këshillit të prindërve pranë SHMQSH “Cvetan Dimov”, është për çdo lloj bashkëpunimi midis fëmijëve të bashkësive të ndryshme, sipas tyre, problem më i madh është politika dhe diskursi politik i politikanëve. Fëmijët, përfshirë këtu edhe bashkësitë ndëretnike, janë viktimat të dëshirave të politikanëve për vota. Çdoherë kur kemi fushata zgjedhore ka incidente midis nxënësve. Qëndrim të ngjashëm ka edhe anëtari i këshillit të prindërve nga shkolla fillore e komunës Saraj ndërkaq, sipas tij, për të pasur sukses në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike përmes arsimit të integruar, politika duhet të qëndrojë mënjanë, sepse shpeshherë politikanët kur kanë nevojë e “tensionojnë” retorikën, e cila ndikon tek të rinjtë. Nëse dëshirojmë të kemi sukses, politika duhet të qëndrojë mënjanë.

Nga ana tjetër, edhe përfaqësuesi i Unionit të nxënësve të shkollave të mesme është i mendimit se ekziston vullnet për implementimin e arsimit të integruar tek palët e interesuara (nxënësit). Deri më tani kanë marrë pjesë në projekte me tema të cilat kanë të bëjnë me jetën ndëretnike, të cilat janë mbështetur edhe nga ana e institucioneve edhe nga ana e organizatave vendase dhe ndërkombëtare dhe për Unionin nuk është problem që kjo politikë të jetë permanente dhe e mbështetur si politikë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Kur bëhet fjalë për implementimin e politikave për përmirësimin e bashkëjetesës infra-etnike në domenin e arsimit përmes komponentit Arsimit të integruar, nxënësit janë të gatshëm që të jenë protagonistë, megjithatë fjalën kryesore e ka Ministria e Arsimit dhe Shkencës e cila duhet të iniciojë politika të këtilla. Në këtë drejtim nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve të shkollave dhe sipas politikave të institucioneve.

## Konkluzione dhe rekomandime

Duke u nisur nga fakti se sistemi arsimor maqedonas në masë të madhe është segregues nga aspekti etnik, veçanërisht arsimit fillor dhe i mesëm, në këtë punim u përpoqëm të identifikojmë një pjesë të politikave të cilat ekzistojnë në nivelin qendror, si dhe mundësinë që e ofron decentralizimi, që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave të arsimit të integruar. Në këtë drejtim, hulumtimi u fokusua mbi analizën e politikave ekzistuese dhe tentativave, të zbatuara në institucionet nacionale, si dhe mundësinë që e ofron decentralizimi me kompetencat e reja në sistemin arsimor. Në këtë kontekst, u realizuan intervista me përfaqësuesit e pushtetit qendror, me përfaqësuesit e pushtetit lokal, me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, të cilët zbatojnë projekte në temën Arsim i Integruar, anëtarët e këshillave të prindërve, mësimmësuesit dhe nxënësit. Analiza dhe përpunimi i intervistave çojnë në drejtim të konkluzioneve si vijojnë:

Një pjesë e intervistave për nevojat e kësaj analize vunë në dukje se funksionimi i arsimit të integruar, deri më tani, është zbatuar me ndihmën e projekteve të mbështetura nga ana e organizatave ndërkombëtare, ndërsa sipas asaj që e theksuan instancat dhe përfaqësuesit e autoriteteve lokale, e gjitha kjo ka të bëjë vetëm me nivelin e Projektit dhe ndërpritet në momentin kur përfundon Projekti, ndërsa nuk ekziston pengesë as tek nxënësit dhe as tek prindërit për zbatimin e politikave të arsimit të integruar.

Pastaj, hulumtimi i përfshirë në këtë analizë e vë në dukje atë se sistemi arsimor maqedonas karakterizohet me mangësi serioze dhe plane për implementimin e komponentit Arsim i Integruar. Me fjalë të tjera, shpeshherë politika ka influencë të madhe mbi zbatimin e politikave të këtilla dhe në përgjithësi e largon mundësinë për kohezion midis nxënësve të bashkësive të ndryshme etnike.

- Në këtë kontekst, protagonistët politikë në nivel qendror dhe lokal mund të jenë promotorë të arsimit të integruar, por megjithatë ata janë protagonistë kryesorë të frenimit të politikave integruese.

- Në këtë drejtim, është e domosdoshme të ndërmerren masa konkrete për zbatimin e politikave të arsimit të integruar, me çka do të integroheshin nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike dhe do të promovohesh bashkëjetesa, vlerat e ndërsjella, dialogu dhe toleranca. Për këto shkaqe, në këtë analizë janë përcaktuar rekomandime të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e politikave arsimore për arsimin e integruar.

- Shteti t'u ndihmojë institucioneve të pushtetit lokal, aty ku ekziston mundësia, të promovohen shkollat në të cilat procesi mësimor do të zbatohet në gjuhë të ndryshme.

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byrja e Zhvillimit të Arsimit të inkorporojnë programe dhe orë për njohjen e kulturës të bashkësive etnike dhe mirëkuptimin multikulturor, veçanërisht në arsimin fillor.

- Fuqizimi i institucioneve arsimore në të cilat nxënësit do të kishin pika të përbashkëta dhe tejkalimin e segregacionit aktual midis nxënësve, veçanërisht në arsimin e mesëm.

- Të promovohen institucionet arsimore të integruara, me qëllim që nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike ta ndjekin mësimin në objektin e njëjtë shkollor.

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës të promovojë aktivitete ose orë edukative në të cilat mësimin do ta ndjekin nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike.

- Të hartohen programe mësimore për promovimin e diversiteteve, multikulturalizmit dhe tolerancës.

- Specifikimi i mekanizmave për promovimin e parimeve të respektit, tolerancës dhe aprovimin në legjislacion lidhur me arsimin e të gjitha niveleve;

- Përbajtje të detyrueshme, të cilat kanë të bëjnë me thellimin e njohurive për të tjerët dhe promovimin e interkulturalizmit në planet dhe programet mësimore (për shembull, lëndët: histori, gjuhë amtare, atdheu ynë, valle dhe vallëzime popullore, hulumtimi i vendlindjes për arsimin fillor);

- Inkorporimi i mekanizmave për trajnimin e kuadrit mësimor në kuadër të arsimit formal dhe mekanizmave për evaluimin e zbatimit të njohurive të këtilla në procesin edukativ-arsimor;

- Inkorporimi i mekanizmave për promovimin e mësimin të gjuhës së tjetrit (gara dhe bursa) në arsimin fillor dhe të mesëm, orë të detyrueshme për mësimin e gjuhës së bashkësisë tjetër.

- Vazhdim i promovimit të bashkëpunimit midis kuadrit mësimor dhe shkollave, të cilat mësimin e zhvillojnë në gjuhë të ndryshme (aktivitete jashtë mësimore, ekskursionet dhe festime të përbashkëta);

- Në shkolla me më shumë gjuhë të evitohen barrierat fizike midis nxënësve me kultura të ndryshme (mësim në objekte të ndryshme, turne të ndryshme dhe ngjashëm);

- Krijimi i paraleleve në të cilat mësimi do të zhvillohet në dy ose tri gjuhë;

- Politika e arsimit të integruar menaxhohet nga ana e komunave, të cilat kanë njohuri më të thella për gjendjet dhe problemet në nivel lokal;

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës të formojë zëra të veçantë të arsimit të integruar gjatë shpërndarjes së mjeteve financiare përmes bllok dotacioneve;

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit duhet të ndërmarrin masa për heqjen e teksteve shkollore të cilët krijojnë stereotipa dhe paragjykime;

- Komunave me mjedis heterogjen etnik t'u ndahen më tepër financa, me qëllim që të promovojnë shkolla të integruara dhe ta realizojnë komponentin e arsimit të integruar në shkolla;

- në sferën e arsimit të lartë, të inkorporohen mekanizma për promovimin e bashkëpunimit midis universiteteve të cilët procesin mësimor e zhvillojnë në gjuhë të ndryshme (projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore, konferenca shkencore dhe ngjashëm).

## Literaturë e përdorur:

- Barbieri, S., Vrgova, R. & Bliznakovski, J. (2013). Overcoming Ethnic-Based Segregation: How to Integrate Public Schools in Macedonia and Bosnia and Herzegovina. European Commission. (2015). The Former Yugoslav Republic of Macedonia: Report 2015.
- Georgieva, L., Velkovski, Z. & Damovska, L. (2014). The Role of Higher Education in Fostering Intercultural Dialogue and Understanding in a Multiethnic Society - The Case of the Republic of Macedonia. International Journal of Education and Research, 125-136.
- Petroska-Beska, V., Najcevska, M., Kenig, N., Ballazhi, S. & Tomovska, A. (2009). Study on multiculturalism and inter-ethnic relations in Education. Skopje: UNICEF Office.
- Spasovski, O., Ballazhi, S. & Friedman, E. (2010). Mapping and Practices for the Preparation of Teachers for Inclusive Education in Contexts of Social and Cultural Diversity: Former Yugoslav Republic of Macedonia Country Report. European Training Foundation.
- Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 91 të datës 20.11.2001) [viti 2016, shkurt, 6]. Shkarkuar nga file: [http://C:/Users/APOSTOL/Downloads/Amandman%20IV,%20V,%20VI,%20VII,%20VIII,%20IX,%20X,%20XI,%20XII,%20XIII,%20XIV,%20XV,%20XVI,%20XVII%20i%20XVIII\\_20112001%20\(1\).pdf](http://C:/Users/APOSTOL/Downloads/Amandman%20IV,%20V,%20VI,%20VII,%20VIII,%20IX,%20X,%20XI,%20XII,%20XIII,%20XIV,%20XV,%20XVI,%20XVII%20i%20XVIII_20112001%20(1).pdf)
- Apostolovska-Toshevska, B. dhe Jurukov I. (viti 2008). Manual për procesin mësimor të lëndës zgjedhore "Atdheu ynë": arsimit fillor. Shkup: Byroja e Zhvillimit të Arsimit.
- Brashnarska, S. dhe Gievski, I. (viti 2008). Manual për procesin mësimor të lëndës zgjedhore "Hulumtimi i vendlindjes". Shkup: Byroja e Zhvillimit të Arsimit.
- Ligji për arsim të lartë (tekst i konsoliduar) (viti 2016, shkurt 6). Shkarkuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës: <http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/zakon-za-visoko-2015.pdf>
- Ligji për arsimin fillor (tekst i konsoliduar) (viti 2016, shkurt 6). Shkarkuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës: <http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/zakon-za-osnovno-20155.pdf>
- Ligji për arsimin e mesëm (tekst i konsoliduar) (viti 2016, shkurt 6). Shkarkuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës: <http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/zakon-za-sredno-2015.pdf>
- Ligji për vetëqeverisje lokale (tekst i konsoliduar) (viti 2002, janar 29): [http://aa.mk/WBStorage/Files/Zakon\\_lokalnata\\_samouprava.pdf](http://aa.mk/WBStorage/Files/Zakon_lokalnata_samouprava.pdf)
- Janevski, V., Iliq, B. dhe Vitanova, A. (viti 2008), Manual për procesin mësimor të lëndës zgjedhore "Valle dhe vallëzime popullore". Shkup: Byroja e Zhvillimit të Arsimit.
- Konferenca për arsim të integruar për tejkalinimin e ndarjeve etnike në shkolla (viti 2013, dhjetor 2013). Shkarkuar nga Qendra për Dialog Nansen Shkup: <http://ndc.net.mk/index.php/mk/ndc-skopje-vo-mediumite/614-konferencija-za-integrirano-obrazovanie-za-nadnivanje-na-etnickite-podelbi-vo-ucilistata>

Konceptet dhe praktika e arsimit të integruar (viti 2013, dhjetor 30). Shkarkuar nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë: <http://www.zels.org.mk/Default.aspx?newsArchive=9bdd77e8-15ae-408e-bd8e-d83df756b3a7&ln=3&year=2013>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (viti 2014). Plani Strategjik Ministria e Arsimit dhe Shkencës 2015-2017. Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë (viti 2010). Hapat drejt arsimit të integruar në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë. Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë.

Mirasçeva, S. (viti 2010). Manual për procesin mësimor të lëndës zgjedhore “Etika e religjioneve”. Shkup: Byroja e Zhvillimit të Arsimit.

Udhëzime nga Lubjana për integrimin e shoqërive diversitare me arsytet (viti 2012). Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare pranë OSBE.

Prezantimi i një pjese të aktiviteteve të Projektit për arsim të integruar “Mësojmë së bashku” (viti 2012, dhjetor 22). Shkarkuar nga A1on.mk: <http://a1on.mk/wordpress/archives/76431>

Fondacioni për Arsim të Integruar e mbajti takimin e parë të Bordit Drejtues (viti 2015). Shkarkuar nga: Foundation for Integrated Education: <http://f4ie.org/mk/fondacijata-za-integrirano-obrazovanie-go-odrza-prviot-sostanok-na-upravniot-odbor/>

Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konfliktëve (viti 2012). Hulumtim i gjendjes fillestare në lidhje me integrimin multietnik në arsim.

Shustereder, J. dhe Simonovska-Janaçkovska, E (viti 2010). Mosha, kontakti, perceptimet: Si i formojnë shkollat marrëdhëniet midis bashkësive etnike. Shkup: Misioni i OSBE në Shkup.

## lista e intervistave

1. Intervistë me Daniella Zaharieva, përgjegjëse e Sektorit të Arsimit pranë Qytetit të Shkupit;
2. Intervistë me Zhika Atanasovski, përgjegjës i Sektorit të Arsimit në Komunën e Kumanovës;
3. Intervistë me Isen Asani, kryetar i Komunës së Tearcës;
4. Intervistë me Besim Aliu, drejtor i SHF “Kirill Pejçinoviç”, Tearcë;
5. Intervistë me Muhamed I., drejtor i Sektorit të Arsimit në Komunën e Tearcës;
6. Intervistë me Teuta Dauti, mësimdhënëse e gjuhës angleze, pjesëmarrëse në Projektin INA;
7. Intervistë me George Nikollov, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, zëvendëskryetar i Grupit të Punës për Arsim Ndëretnik pranë MASH;
8. Zhaneta Çonteva, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, anëtare e Grupit të Punës për Arsim Ndëretnik pranë MASH;
9. Intervistë me Ahmed Qazimi, drejtor i Sektorit për Punë të Përgjithshme pranë Komunës së Tetovës;
10. Intervistë me Nebojsa Mojsoski, koordinatori i Projektit për Arsim Ndëretnik pranë QMSHQ;
11. Intervistë me Jasir Asani, nxënës, kryetar i Unionit të Nxënësve pranë SHMQSH “Cvetan Dimov” – Shkup;
12. Intervistë me Veton Zekolli, projekt menaxher në Qendrën për Dialog Nansen-Shkup;
13. Intervistë me Fidan Aliu, anëtar i Këshillit të prindërve pranë shkollës fillore në komunën e Sarajit;
14. Intervistë me Ekrem Kadri, përfaqësues i Këshillit të prindërve pranë SHMQSH “Cvetan Dimov” – Shkup.

# PROPOZIM POLITIKA E ARSIMIT TË INTEGRUAR

Profesor inordiner Dr. Goran Janev, Mr. Sonja Stojadinović, Mr. Aneta Smit Guleva

## Rezime/abstrakt

Sistemi aktual i arsimit në Republikën e Maqedonisë është tërësisht i segreguar dhe çon në ndarje shoqërore të mëtutjeshme dhe të thellë. Ky rrezik është fakt i përcaktuar dhe me qëllim që të tejkalohet ky problem u hartua dhe tanimë vite me radhë zbatohet Strategjia për arsimin e integruar në nivel nacional. Struktura organizative e sistemit arsimor është shumë e centralizuar dhe me këtë e asfikson vetiniciativën eventuale. Në mënyrë plotësuese, nga personat më përgjegjës të cilët duhet t'i zbatojnë programet – mësimdhënësit, këto programe perceptohen si imponim i radhës së obligimeve shtesë për të cilat ata nuk shpërblehen, ndërkaq u kërcënohet edhe rreziku nëse nuk i përmbushin. Motivimi i dobët, i cili është identifikuar gjatë këtij hulumtimi, është i pranishëm edhe tek prindërit të cilët nuk janë përfshirë në mënyrë adekuate, përkatësisht çdo gjë ka të bëjë me përfaqësuesit institucional. Pastaj, qasja ekzistuese institucionale i materializon dhe i përforcon ndarjet etnike me atë që në mënyrë të drejtpërdrejtë i referohet njëfarë integrimi, duke e supozuar dhe me këtë duke e theksuar, dallimin ekzistues. Kështu, vështirë do të tejkalohet ndarja.

Duke i identifikuar këto dobësi strukturore dhe sistematike, qasja e ofruar e stimulon vetiniciativën. Me këtë sigurohet përfshirje dhe angazhim të faktorëve të vet-stimular, në vend që të mbështetet mbi iniciativa të imponuara. Temat, të cilat e stimulojnë dimensionin universal human i tejkalojnë dhe i kapërcejnë problemet e politizuara etnike. Programet e identifikuar dhe të zhvilluara nga faktorët e drejtpërdrejtë premtajnë qëndrueshmëri, origjinalitet dhe përshtatje të plotë në mjediset specifike lokale. Qëndrueshmëria e aktiviteteve të këtilla jashtëshkollore premtan shumë më tepër sesa programet integruese të imponuara nga lartë. Vet qasja angazhohet për arsim inkluziv, i cili do të krijojë qytetarë transparentë dhe të ndërgjegjshëm, dhe jo subjekte të integruara politike të cilët janë të detyruar ta pranojnë kategorizimin etnikë. Komponenti ekologjik, solidar, human dhe social është stimulim për një qytetari aktive dhe vigjilente e cila problemet e veta nuk ua delegon në mënyrë pasive disa qendrave të tjetërsuara të fuqisë, por me vetiniciativë i zgjidh dhe tejkalon.

## Hyrje

Arsimi në Republikën e Maqedonisë, nga njëra anë, i kënaq nevojat për ruajtjen e nevojave gjuhësore dhe identitare të bashkësive etnike më të mëdha në vend, njëkohësisht duke krijuar hendek midis tyre. Shkollat ose janë plotësisht të ndara ose nxënësit janë të ndarë në turne të ndryshme dhe gjithsesi janë në klasë të ndara. Sistemi arsimor i rregulluar në këtë mënyrë është burim i segregimit më të gjerë shoqëror (Barbieri, Vrgova, Bliznakovski, 2013: 3). Ky konstatim nuk është ndonjë shpikje. Kjo dihet qëmtoi, ndërsa në një periudhë më të gjatë kohore ndërmerren masa për tejkalimin e segregacionit. E kundërta e segregacionit është integrimi dhe së këtejmi nuk duhet të na befasojnë masat dhe politikat e ndryshme, si dhe strategjitë për arsimin e integruar. Programet më të reja dhe disa nga programet aktuale të cilat aplikohen do të prezantohen në vijim. Do të sugjerohet se nocion shumë më adekuat është arsimi “inkluziv”, meqë inkluziviteti nënkupton barazi dhe mundësi të barabarta dhe jo ndarje e cila në mënyrë plotësuere do të integrohej. Sido që të jetë, kurrfarë zbulimi nuk është as informata se këto masa nuk i japin rezultatet e dëshiruara, së paku jo në ndonjë masë përgjithësisht të pranuar. Prandaj, ofrojmë qasje të modifikuar të disa nga masat e ndërmarra, por para së gjithash qasje e cila kërkon centralizim minimal dhe menaxhim nga lartë, dhe elementi më i rëndësishëm, nëse e njëjta funksionon premtori vetë-qëndrueshmëri në afat më të gjatë. Gjithsesi se efektet do të ishin më gjithëpërfshirëse nga arsimi i integruar dhe do të kontribuojnë për një shoqëri më të integruar.

Elementi kyç i qasjes tonë është fakti se nuk e përmend dhe as që e glorifikon dhe mistifikon arsimin e integruar. Integrimi nuk arrihet përmes fjalëve për të njëjtin, por përmes praktikës integruere. Kjo praktikë, nëse gjithnjë e më shumë i shmanget integritit të disa bashkësive etnike të imagjinuara, të materializuara si qëllim, aq më shumë do t'i afrohet qëllimit. Në vend të përmbajtjeve integruere të krijuara me dashje, ofrohet kthimi në temat universale, probleme të përgjithshme dhe interesa mbarë-njerëzore. Tejkalimi i identiteteve të fiksuara është i mundshëm nëse pranohet kompleksiteti dhe diversitetet të cilët ekzistojnë jo vetëm në grupet dhe kategoritë e materializuara, por nëse pranohet se diversitetet i hasim tek çdo individ (Bodenhausen, 2010). Duke e theksuar rëndësinë e një sërë çështjesh të pazgjidhura dhe të hidhura të shoqërisë tonë dhe mjedisit natyror, si dhe duke e theksuar mundësinë për ndërmarrjen e hapave të drejtpërdrejta personale, por të bashkuar, hapa për përmirësimin e tyre do të mundësojmë që nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit të përkujtohen në vlerat universale njerëzore. Duke iu dhënë mundësi të vetorganizohen dhe të bëjnë ndryshime, do t'u ndihmojë edhe të çlirohen nga shtrëngimet partiake të identitetit. Maqedonia është vend në të cilin ento-nacionalizmi është promotor politik dominant dhe manipulimi me identitetet e fiksuara dhe të politizuara është i domosdoshëm për funksionimin e këtij sistemi. Duke e stimuluar vetëdijen dhe aktivizmin tek të rinjtë, në bashkëpunim me prindërit dhe mësimdhënësit e tyre, do t'i detronizojë temat etnike dhe politizimin e tyre, do të kontribuojë për tejkalimin e ndarjeve artificiale dhe do t'i vë në pah nevojat e domosdoshme për veprim të përbashkët.

Si bazë e qasjes së ofruar e marrim teorinë e kontaktit ose “hipotezën e kontaktit”, e cila tanimë gjysmë shekulli zhvillohet, para së gjithash në fushën shkencore të psikologjisë sociale (Pettigrew, Tropp, 2006; Hewstone, 2009). Duke e mbindërtuar pikëpamjen fillestare të Xhorxh Alport (Natyra e paragjykimeve, 1954), i cili i vendosi postulatet e problemit të stereotipave dhe paragjykimeve në interaksionin njerëzor kah fundi i vitit 1950, kjo disiplinë e trajton, rishikon dhe hulumton supozimin se kontakti midis pjesëtarëve të kategorive të ndryshme të njerëzve çon në mirëkuptim të tyre më të madh të përbashkët dhe në njohjen e diversiteteve. Hulumtimet më të reja, të cilat e rafinojnë teorinë e kontaktit, vënë në dukje se ka ndikim në tejkalimin e paragjykimeve dhe raportit të fuqisë, përkatësisht statusit shoqëror (Henry, Hardin, 2006). Thënë më saktë, pjesëtarët e grupit, me status më të lartë, më vështirë i ndryshojnë qëndrimet e tyre. Ky komponent është veçanërisht i rëndësishëm nëse synon t'i tejkalojë stereotipat dhe paragjykimet negative të cilët janë të ngulitura tek popullsia në Maqedoni.

Ka mundësi që shpërfillja e këtij aspekti të jetë pengesa më e madhe për zbatimin efektiv të programeve ekzistuese të arsimit të integruar. Në qasjen tonë nuk ofrojmë informacione të detajuara në lidhje me dallimet dhe relativizmin e tyre për rritjen e tolerancës. Përkundrazi, ne ofrojmë situata të kontaktit të cilat i tejkalojnë, kapërcejnë dhe neglizhojnë diversitetet të prodhuara nga diskursi politik në vend dhe stimulojnë mendime për nevojat e përgjithshme njerëzore dhe perceptimin dhe qëndrimin ndaj njëri tjetrit, solidaritetin e përgjithshëm dhe unitetin dhe jo ndarje e përçarje: dhe mosmenaxhim me dallimet e këtilla, por tejkalimin e tyre. Specifikimi i vlerave universale të njeriut dhe stimulimi i senzitivitetit për çështje siç është: mjedisi jetësor i rrezikuar, tejkalimi dhe lehtësimi i ndarjes sociale, zhvillimi i empatisë për kategoritë vulnerabile, siç janë personat e moshuar, të vetmuar dhe të pafuqishëm dhe personat me aftësi të kufizuara, ka për qëllim të kontribuojë në drejtim të tejkalimit të dallimeve statusore, jo vetëm të atyre etnike, që është veçanërisht e rëndësishme nëse kemi situatë të mbivendosjes së përkatësisë etnike me pozitën statusore në shoqëri.

Propozimi ynë për hulumtimin e mundësisë sa i përket mundësisë për zbatimin e politikës publike për arsimin e integruar në njësitë e vetëqeverisjes lokale e ka parasysh rolin e kufizuar të komunave në krijimin dhe miratimin e përmbajtjeve arsimore dhe prandaj ofron organizim të aktiviteteve jashtëshkollore. Theksi i këtyre aktiviteteve jashtëshkollore është mbi vlerat universale humanitare të cilat, për fat të keq, janë neglizhuar në procesin edukativ arsimor dhe në përgjithësi në fushën publike në Republikën e Maqedonisë. Duke e pasur në konsideratë edhe rolin e limituar të ofertës së përmbajtjeve mësimore, e cila rregullohet në mënyrë të centralizuar, fokusohemi mbi përmbajtjet jashtëshkollore, të cilat lënë hapësirë për vetorganizim. Qasja për arritjen e efektit integruar konsiston duke i vënë në dukje ato probleme dhe çështje të cilat na prekin të gjithëve, pa marrë parasysh përcaktimet tona identitare.

Temat dhe fushat e mundshme, të cilat do t'i trajtonin aktivitetet jashtëshkollore, plotësisht i injorojnë diversitetet etnike dhe religjioze, të cilët janë mobilizuesit më të shpeshtë dhe më të fuqishëm në Maqedoni. Si pikë referimi e kemi informatën se manipulimi politik me këto kategori të diferencimeve sociale krejtësisht do ta pamundësonte, ose në masë të madhe do ta shtrembëronte, perceptimin e politikës së integruar e cila do të mbështetej mbi një qasje të këtyllë të drejtpërdrejtë. Së këtejmi, qasja jonë është absolutisht mbi-etnike dhe mbi-kombëtare. E përbashkëta e të gjitha këtyre nën-temave si dhe e aktiviteteve që kanë rezultuar nga të njëjtat është nevojë reale për veprim në të mirë të përgjithshme. Me realizimin e qëllimeve të veçanta për përmirësimin e gjendjes së përcaktuar si e mirë e përgjithshme arrihet veprim i unifikuar dhe vetorganizim. Politikat e ofruara e zhvillojnë vetëdijen për solidarizim dhe bashkëpunim të ndërsjellë për arritjen e interesave të përbashkëta.

Agnosticizmi apolitik dhe etno-religjioz në qasjen tonë është përzgjedhur me dashje si esencialisht më i përshtatshmi. Para së gjithash, për shkak të sensitivitetit të cilësdo qoftë ndërhyrje në fushën e arsimit, megjithatë edhe për shkak të moshës së pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë. Qëllimi është të identifikohen dhe ndriçohen problemet e përgjithshme si dhe zgjidhja e tyre përmes shoqërimit. Vlerat elementare humane dhe problemet esenciale mbarë-njerëzore të jetës kontemporane do t'u për afrohen nxënësve përmes identifikimit të drejtpërdrejtë të problemeve dhe përgatitjes së aktiviteteve të cilat vetë ata do ti krijojnë dhe me këtë do të garantohet interesimi i tyre për zbatim si dhe do ju ofrohet mundësia të marrin pjesë në krijimin e aksioneve. Mësimnxënia përmes praktikës, është sigurisht metoda më efikase pedagogjike, ndërsa aplikimi i të njëjtës është garanci për mbamëndje të gjatë të leksioneve të mësuara.

Atë që shpresojmë se do ta arrijmë tek nxënësit është ta kuptojnë gjerësinë e problemeve mbarënjëzore të natyrës ekologjike dhe sociale dhe mundësinë për tejkalimin e tyre përmes veprimeve të përbashkëta, vullnetare dhe të vetorganizuara.

Me këtë do t'u ndihmojmë ta ndjejnë fuqinë e të jetuarit në solidaritet brenda shoqërisë, t'i ndjejnë synimet e përbashkëta dhe domosdoshmërinë e funksionimit brenda një bashkësie me individë të barabartë e jo me individë egoistë ose me individë kolektivisht të subordinuar. Ndërtimi i bashkësisë mbi këto bazamente e tejkalon diversitetin etnik, religjioz, madje edhe atë klasor dhe mundëson të kuptohen vlerat dhe nevojat themelore humane të çliuara nga të gjitha ndarjet ideologjike, politike-partiake dhe ndarje tjera.

## **Pasqyrë e hulumtimeve dhe praktikave ekzistuese**

Në këtë seksion do të prezantohet sistemi arsimor dhe korniza e tij ligjore, rrënjësja në sistemin shoqëror dhe nivelet përkatëse të përgjegjësisë dhe kompetencës. Kjo është e domosdoshme në mënyrë që të parashikohet inkorporimi i praktikave të reja inkluzive, përmes aktiviteteve jashtëshkollore. Pastaj, vijon analiza e programeve ekzistuese zyrtare të arsimit të integruar dhe evaluimi i përparësive dhe dobësive të tyre. Në bazë të kësaj analize e postulojmë propozimin tonë për politikë publike.

## **Korniza ligjore për funksionimin e arsimit fillor në RM**

Shkollat fillore ndahen sipas themeluesit dhe mund të jenë shtetërore dhe komunale. Shkollat shtetërore i themelon Qeveria ndërsa shkollat komunale vetë komunat në bazë të mendimit të pranuar nga Qeveria. (Neni 16, Ligji për arsimin fillor) Financimi i shkollave fillore është në kompetencë të komunave (Ligji për vetëqeverisje lokale, Neni 22). Sipas Nenit 25 të Ligjit në fjalë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcakton konceptin e arsimit dhe edukimit në bazë të të cilit miratohet plani mësimor dhe programet mësimore, ndërsa në shkollat fillore programi edukativ-arsimor organizohet dhe realizohet sipas planit mësimor, të cilin me propozim të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, e përcakton Ministri.

Organ udhëheqës në shkollat fillore është Këshilli i Shkollës i cili përbëhet nga nëntë anëtarë: tre përfaqësues nga mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionistë dhe edukatorët e shkollës, tre përfaqësues nga prindërit e nxënësve, dy përfaqësues nga themeluesi dhe një përfaqësues nga Ministria. Mandati i anëtarëve zgjat tre vjet, ndërsa mandati i prindërve zgjat deri në përfundimin e shkollimit të fëmijës së tyre, por jo më gjatë se tre vjet, kurse vendimet miratohen me shumicë të numrit të votave. Anëtarët e këtij organi nga mësimdhënësit i zgjedh Këshilli i Prindërve. Ky organ e rregullon statutin, programin vjetor dhe raportin e shkollës para Këshillit Komunal, miraton program për zhvillimin e shkollës, program për instalimin e standardeve më të larta dhe programe tjera, propozon plan financiar deri te themeluesi, propozon llogari përfundimtare deri te themeluesi dhe shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit si dhe obligime të tjera të përcaktuara me ligj.

Nga një aspekt tjetër, organ udhëheqës i shkollës është Këshilli i Mësimdhënësve të cilin e përbëjnë mësimdhënësit lëndor e klasor dhe bashkëpunëtorët profesionistë, ndërsa mbledhjet i thërret dhe me të njëjtat kryeson drejtori. Ky organ është përgjegjës për programin vjetor të zhvillimit dhe për programin e punës, e shqyrton planin mësimor dhe programet mësimore si dhe realizimin e tyre, i shqyrton planet e vet-evaluimit të bërë dhe evaluimit integral, e shqyrton suksesin e nxënësve dhe e aprovon avancimin e tyre në shkollë, e shqyrton raportin vjetor për punën e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë dhe raportin nacional për punën e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, si dhe propozon masa përkatëse, parashtron propozime për avancimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionistë të shkollës, vendos për masat edukative të nxënësve.



Cilësia e procesit mësimor në arsimin fillor, sipas kornizës ligjore, sigurohet përmes Këshillit të Shkollës i cili çdo katër vjet miraton Program për zhvillimin e shkollës. Në të njëjtin janë marrë parasysh rezultatet e vet-evaluimit të realizuar nga komisioni i shkollës, ndihma këshillëdhënëse dhe profesionale e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, pastaj rekomandimet e raportit të evaluimit integral i cili zbatohet nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit, si dhe rezultatet nga evaluimi ekstern të cilat janë përfshirë në raportin vjetor për punën e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionistë nga Qendra Shtetërore e Provimeve. Vet-evaluimi bëhet në çdo dy vjet, ndërsa e realizon komisioni i përbërë nga anëtarët e mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionistë dhe prindërve, i formuar nga Këshilli i Shkollës, sipas propozimit të drejtorit. Procesi i vet-evaluimit i përfshin fushat e organizimit dhe realizimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, sukseset e nxënësve, zhvillimin profesional të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionistë dhe edukatorëve, komunikimin me publikun, bashkëpunimin me prindërit dhe mjedisin lokal. Raporti nga vet-evaluimi me propozim masat për përmirësime, i dërgohet Këshillit të Shkollës, drejtorit dhe themeluesit të shkollës. Kompetent, për veprim lidhur me propozim masat për përmirësim, është drejtori dhe Këshilli i Shkollës. Sipas Ligjit për arsimin fillor, Ligjit për buxhetet e Republikës së Maqedonisë, Ligjit për realizimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, financimi i shkollave fillore bëhet përmes bllok dotacioneve dhe dotacioneve me dedikim nga Buxheti shtetëror i RM-së. Përlllogaritja e lartësisë së mjeteve financiare të cilat do t'i pranojë shkolla për menaxhimin me shkollat varet nga numri dhe dendësia e popullsisë dhe nga numri i nxënësve në atë komunë. Ministria e Arsimit përcakton masa dhe kriteret sipas të cilave do të shpërndahen mjetet për shkollat fillore shtetërore, ndërsa Këshilli i Komunës i përcakton masat dhe kriteret për shkollat fillore komunale.

Mekanizmi kontrollues i punës së shkollave pjesërisht është edhe në duart e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. Në kompetencë të tij është: kontrolli i funksionimit të kushteve për ushtrimin e veprimtarisë mësimore, kushtet nëpër shkolla dhe konviktet e nxënësve, procesi edukativ-arsimor nga moshë parashkollore deri në arsimin e mesëm, kushtet e veçanta për zgjedhjen dhe përsosjen e mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionistë dhe edukatorëve, përdorimi i teksteve shkollore, realizimi i planeve dhe programeve mësimore dhe aktivitetet jashtëshkollore. Megjithatë, kontrollin e përgjithshëm dhe të detajuar e bën Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) nga arsimit parashkollor deri në arsimin e mesëm, në arsimin e mesëm profesional dhe arsimin dhe lëndët profesionale, arsimin e specializuar dhe arsimin për të rritur, arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe arsimin e fëmijëve të qytetarëve të RM-së jashtë vendit të cilët e mësojnë gjuhën dhe kulturën maqedonase. Byroja për Zhvillimin e Arsimit ia propozon Ministrit konceptet e arsimit dhe programet mësimore nga moshë parashkollore deri në arsimin e mesëm. Gjithashtu, përpilon standarde arsimore, si dhe standarde për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, përpilon koncepte për tekste shkollore, programe për botimin dhe vlerësimin profesional të teksteve shkollore, propozon tekste deri te Qendra Shtetërore e Provimeve për vlerësimin ekstern të nxënësve të arsimit fillor, të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit të mesëm profesional, si dhe orarin e përgjithshëm për vlerësimin e arritjeve të nxënësve për lëndët e arsimit fillor, arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe artistik dhe arsimit të mesëm profesional. Kontrolli i plotë, sa i përket cilësisë së teksteve shkollore, programeve mësimore dhe testeve eksternë të nxënësve, bashkë me kontrollin e progresit të kuadrit mësimor, është në kompetencë të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.

Ekskursionet dhe aktivitetet e tjera të lira të nxënësve rregullohen përmes Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve të tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore (Ligji për arsimin fillor), në të cilin është përcaktuar se për çdo program për ekskursionet dhe aktivitete tjera të lira, të cilin e përpilon ekipi profesional, mendim të veçantë jep Këshilli i Prindërve, Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Këshilli i Komunës, më së paku 30 ditë para realizimit të tyre.

Në bazë të këtij mendimi, Këshilli i Shkollës e miraton çdo program për ekskursion dhe aktivitete tjera të lira, më së paku 20 ditë para realizimit të tij. Këtu shtrohet çështja e zbatimit të aktivitetit të propozuar jashtëshkollor. Kjo është struktura e sistemit arsimor dhe është evidente se do të ishte naive të pritej që vetëm me një entuziazëm shterp do të stimulohen mësime dhe nxënës, prindërit t'u bëjnë ballë të gjitha këtyre procedurave administrative. Prezantimet motivuese për dobinë dhe qasjen e drejtë do të kërkojnë vëmendje të posaçme.

Objekt të analizës ishin: Ligji për vetëqeverisja lokale, Ligji për arsimin fillor, Ligji për njësitë e vetëqeverisjes lokale, Ligji për Byronë e Zhvillimit të Arsimit, Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm, Ligji për Inspeksion Arsimor, Ligji për tekste shkollore, Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore (Ligji për arsimin fillor).

### **Praktika në implementimin e masave të cilat mundësojnë arsim të integruar**

Multientiteti është realitet në Republikën e Maqedonisë, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, nga miratimi i saj e deri më sot, fokusohet që këtë realitet ta shndërrojë në angazhim politik në makro-nivel përmes masave për integrimin e bashkësive minoritare përmes punësimit në administratën publike dhe lokale. Megjithatë, në nivelin më të gjerë shoqëror nuk ekziston ose mungon kohezioni në nivel personal, e që është kërcënim për thellimin e hendekut midis diversiteteve në bazë etnike ose thënë ndryshe, parashtrahet pyetja se a mjafton, nga këndvështrimi afatgjatë, politika e integritit përmes punësimit në administratën publike të bashkojë një kohezion më të thellë në shoqëri dhe ta eliminojë kërcënimin nga thellimi i hendekut në bazë të etnicitetit. Nga viti 2008 ekzistojnë përpjekje që të bajpasohet ky hendek përmes sistemit arsimor në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare. Në vitin 2010 është miratuar Strategjia në të cilën në mënyrë parimore janë prezantuar disa koordinata kryesore për ndërtimin e kohezionit:

**a) promovimi i integritit** përmes planeve dhe programeve mësimore dhe aktiviteteve jashtëshkollore në shkollat fillore dhe të mesme;

**b) adaptimi i programeve mësimore dhe teksteve shkollore** përmes inkorporimit të çështjeve të tolerancës së ndërsjellë dhe komunikimit ndërkulturor, me qëllim të evitimit të stereotipave dhe jotolerancës negative dhe inkorporimit dhe stimulimit që në mënyrë kritike të paraqiten gjërat. Në këtë pjesë, angazhimi është që MASH ta merr përgjegjësinë, përveç për licencimin e botimit të teksteve shkollore, edhe për kontrollin e përmbajtjes së teksteve shkollore të cilat shtypen, për çka është e domosdoshme të vendoset edhe mekanizmi kontrollues;

**c) rritja e njohurive, vetëdija dhe qasja e mësimeve të tanishëm dhe të ardhshëm**, në drejtim të eliminimit të antagonizmave dhe stereotipave në bazë të etnicitetit përmes ligjërimit dhe edukimit;

**ç) veprim i koordinuar nga niveli qendror deri tek ai lokal me kompetencat komunale nga procesi i decentralizimit** në pjesën e shkollave fillore, në mesin e pikave më të rëndësishme janë: përfshirja e këshilltarëve komunal për arsim dhe inspektorëve të autorizuar, sigurimi i kontinuitetit sa u përket vendeve të punës së mësimeve dhe përfshirja e ndihmësdrjetorëve.

Tani për tani, pikat kryesore të dobëta janë identifikuar në nivel të fluktacionit tejet të madh të kuadrit mësimor, me çka rrënohen përpjekjet e investuara në krijimin e vetëdijes dhe aftësive dhe reduktohet ose pamundësohet zbatimi i efektit multidimensional nga njohuritë e fituara. Rrjedhimisht me këtë, pamundësohet impakti i dëshiruar i arritjeve të indikatorëve matës për ndikimin mbi ndërtimin kohezionit ndëretnik, ndërkaq shtrohet pyetja rreth inkorporimit të metodologjisë për monitorimin dhe evaluimin si dhe autorizimet dhe kompetencat e inspektorëve komunal të arsimit. E gjithë kjo ka të bëjë me fushëveprimin e punës së ndihmësdrejtorëve të emëruar në disa shkolla më të mëdha dhe drejtorëve të shkollave të cilët a priori merren me çështjet e bashkësive minoritare dhe integrimin, por tani për tani vetëm në “kuptimin numerik”. Ajo që mungon është përkufizimi i qartë i detyrave të këtyre pozitave, në pjesën e ndërtimit të kohezionit ndëretnik, ku niveli i dëshiruar është transparenca dhe përgjegjësia më e madhe në procesin e emërimit të tyre dhe sigurimin e departizimit gjatë administrimit me shkollën dhe punën e Këshillave shkollor, ku anëtarë janë edhe prindërit.

Nga të dhënat e Raportit të titulluar “Bridges and Divisions in Education” të Misionit të OSBE në Republikën e Maqedonisë për shkollat e arsimit fillor, janë të aksesshme të dhënat si vijojnë:

- Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë 332 shkolla fillore, nga të cilat 48% në zonat urbane, 52% në ato rurale
- Në të njëjtat arsimohen 200.436 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, prej të cilëve 51,7% janë meshkuj dhe 48,3% femra
- 53% janë maqedonas, 34% shqiptarë, 5% romë, 4% turq, ndërsa 4% të tjerë. 64% e këtyre nxënësve
- procesin mësimor e ndjekin në gjuhën maqedonase, 33% në gjuhën shqipe dhe 3% në gjuhën turke
- 69% e shkollave fillore mësimin e zhvillojnë në një gjuhë, përkatësisht 74% e të gjitha shkollave në të cilat procesi mësimor zhvillohet në një gjuhë janë në gjuhën maqedonase, ndërsa 26% në gjuhën shqipe
- 31% e shkollave fillore janë shumë-gjuhësore: 18% me proces mësimor në gjuhën maqedonase dhe shqipe (19% e nxënësve), 4% në gjuhën maqedonase, shqipe dhe gjuhën turke (7% e nxënësve), 6% në gjuhën maqedonase dhe turke (5% e nxënësve) dhe 3% në kombinime tjera
- 73,3% e nxënësve (98.947) të cilët procesin mësimor e ndjekin në gjuhën maqedonase janë në shkolla një-gjuhësore dhe 26,7% (35.863) në shkolla shumë-gjuhësore, ndërsa 51,1% e nxënësve (35.863) procesin mësimor e ndjekin në gjuhën shqipe në shkollat një-gjuhësore dhe 48,9 % në shkolla shumë-gjuhësore

Në arsimin fillor, nga 200.436 nxënës në 332 shkolla fillore, 53% janë maqedonas dhe 34% shqiptarë, që do të thotë se këto 2 bashkësi përbëjnë 87% të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Të gjithë nxënësit, procesin mësimor e ndjekin në paralele të ndara ose: maqedonas (64%), shqiptarë (33%), turq (3%), serbë dhe boshnjakë (nën 1%) dhe asnjëherë nuk përzihen. 67% e të gjithë nxënësve janë në shkolla një-gjuhësore që do të thotë se asnjëherë nuk komunikojnë me të tjerët në gjuhën e fëmijëve në mjedis të njëjtë shkollor. 33% e nxënësve procesin edukativ-arsimor e ndjekin në shkolla shumë-gjuhësore, prej të cilave vetëm 26% kanë të bëjnë me kombinimin maqedonisht-shqip. Konkluzioni në këtë raport është se gjysma e këtyre 26% ose midis 10% dhe 13% nxënës të bashkësisë shqiptare dhe maqedonase në arsimin fillor kanë mundësi reale të integrohen në mjedisin shkollor në të cilin takohen. Pikërisht për këtë shkak, në qasjen tonë nuk shkojmë në ndonjë integrim të bashkësive të ndara, por në përafrim, shoqërim dhe veprim të përbashkët për qëllime të rëndësishme të përbashkëta, të detektuara dhe të zgjedhura nga vet nxënësit, mësimmhënësit dhe prindërit.

**1. Projekti për Integrim Ndëretnik në Arsim (PINA)** në nivel qendror është zbatuar nga Ministria e Arsimit, nga muaji dhjetor i vitit 2011 deri në dhjetor të vitit 2015. Synimi kryesor o Projektit është ndërtimi i vetëdijes dhe sigurimi i trajnimeve të ndryshme, ndihmë teknike dhe stimulimi për këshillat e shkollave, drejtorët e shkollave, mësimdhënësit dhe kuadrot administrativ sa i përket mbështetjes së integritimit ndëretnik në arsim. Projekti si target grupe i specifikon: shkollat fillore dhe të mesme, nxënësit, mësimdhënësit, anëtarët e këshillave shkollorë, prindërit dhe bashkësitë lokale. Arritja e synimit organizohet përmes zbatimit të aktiviteteve në katër komponentë: informimi i publikut dhe bashkësisë, ndërtimi i kapaciteteve të udhëheqësisë së shkollës dhe mësimdhënësve, krijimi i shkollave model për integrimin ndëretnik dhe stimulimi i shkollave dhe bashkësive përmes fondit për rikonstruimin e shkollave.

Sipas informatave nga Raporti për evaluimin e Projektit, aktivitetet e ndërmarra në nivel të ngritjes së vetëdijes për marrëdhëniet ndëretnike dhe bashkëjetesë me sukses i adresojnë nevojat e detektuar të nxënësve, mësimdhënësve, por më pak të prindërve dhe akoma më pak të shërbimeve të vetëqeverisjes lokale. Njëkohësisht, vetëqeverisja lokale është detektuar si veçanërisht e rëndësishme për qëndrueshmërinë e angazhimeve për kohezion në afat të gjatë, duke i marrë parasysh kompetencat e tyre sa u përket shkollave fillore. Përmes Projektit u realizuan trajnime dhe u ndërmorën masa inkurajuese për gazetarët, në mënyrë që të njëjtët të investigojnë dhe të bëjnë storje dhe risi të suksesshme në lidhje me aktivitetet e Projektit. Megjithatë, problemi crucial në informimin është identifikuar në nivel të mediave nacionale tek të cilat, për dallim nga angazhimet e atomizuara për raportim pozitiv në nivel lokal, përmes televizioneve lokale, qasja e televizioneve nacionale akoma në masë të madhe i theksojnë dallimet dhe konfliktet etnike në vend të unitetit dhe integritit të suksesshëm.

Sa i përket rritjes së kapaciteteve të mësimdhënësve dhe udhëheqësive, në Raportin e njëjtë theksohet gatishmëria e rritur tek edukatorët / mësimdhënësit për bashkëpunim ndëretnik përmes aktiviteteve jashtëshkollore, megjithatë theksohet mungesa e mbështetjes financiare për një gjë të këtillë, e cila pritet nga vetëqeverisja lokale dhe Ministria e Arsimit në rastin kur ndihma nga donatorët do të shteret. Ekziston edhe pakënaqësi tek kuadri mësimdhënës meqë këto aktivitete i konsiderojnë si angazhim papagesë të cilin ata e investojnë jashtë përshkrimit të vendit të punës. Sa u përket prindërve, të cilët janë hallka kryesore në procesin edukativ, ekziston hapësirë për krijimin e qasjes e cila do t'i tejkalojë aktivitetet në drejtim të ngritjes së vetëdijes për marrëdhëniet ndëretnike. Pastaj, duke e marrë në konsideratë konceptin e qasjes, është detektuar presion i caktuar mbi shkollat për krijimin e partneriteteve dhe aktiviteteve të përbashkëta në bazë të gjuhës mësimore; me fjalë të tjera imponohen aktivitete me partnerë të cilët praktikojnë gjuhë tjetër mësimore. Së këtejmi, shkollave u bëhet presion me dashje në të cilat procesi mësimor zhvillohet në gjuhët minoritare dhe humben mundësitë për një integrim shumë-kulturor dhe shumë-etnikë jashtëshkollor të shkollave në të cilat procesi mësimor zhvillohet në gjuhën maqedonase, ndërsa shkollohen edhe fëmijë të bashkësive tjera.

Sa i përket komponentit të orientuar në drejtim të krijimit të shkollave të cilat do të shërbejnë si model, sipas Raportit është arritur një dallim i dukshëm në integrimin dhe bashkëpunimin midis nxënësve, mësimdhënësve madje edhe midis prindërve në raport me shkollat të cilat nuk janë përfshirë me Projektin. Këtu, si i pakënaqshëm vërehet thellimi i përfshirjes së prindërve për arritjen e një ndryshimi më të rëndësishëm koheziv, siç është kultura e sjelljes, në nivel të bashkësisë. Nga analiza e rolit të prindërve dhe angazhimit të tyre në pjesën e miratimit të vendimeve, sa u përket ideve dhe temave të caktuara të përfshira me aktivitetet jashtëshkollore ose me ngjarje specifike shkollore, kryesisht veçohen disa mangësi: mungesa e besimit nga prindërit e shkollës dhe nga të punësuarit rreth aktiviteteve të cilat e synojnë integrimin ndëretnik, mungesa e përfshirjes në miratimin e vendimeve dhe pjesëmarrjen e prindërve përmes këshillave shkollor edhe përkrah përpjekjeve të Projektit.

Ka hapësirë serioze në të cilën duhet të punohet në mënyrë më aktive, meqë prindërit përjetohen si vëzhgues pasivë, ndërsa mënyrat të cilat zbatohen tani (Këshillat Shkollorë) nuk sigurojnë një stimulim të tyre më esencial në bashkë-krijimin e integritit, ndërsa me këtë nga harta humbet një aleat i rëndësishëm në drejtim të reduktimit të hendekut shoqëror në bazë të etnicitetit dhe në nivel individual.

**2. Modeli Nansen për Arsimin e Integruar** është prezantuar si model i ri i arsimit në Republikën e Maqedonisë, me të cilin targetohen nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit e bashkësive të ndryshme etnike përmes procesit bashkëkohor edukativ-arsimor. Ky Program zbatohet nga viti 2007 përmes Qendrës për Dialog Nansen në 12 shkolla fillore. Modeli e mbështet integrimin e nxënësve – pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike të cilët qëndrojnë bashkërisht dhe e ndjekin procesin mësimor (secili në gjuhën e vet amtare) në objekt të njëjtë shkollor dhe në turne të njëjta. Janë vendosur një sërë modulesh dhe janë mbajtur trajnime për mësimdhënësit dhe për prindërit, me çka synohet në ngritjen e njohurive dhe aftësive të tyre në procesin e integritit dhe krijimit të kohezionit në bashkësi. Programet e zhvilluara janë integruar në platformën onlajn përmes së cilës mund të shkëmbehen përvojat dhe të merren resurse didaktike. Programet janë zhvilluar në korrelacion midis përmbajtjeve të programeve zyrtare mësimore dhe programeve për aktivitete të karakterit joformal, jashtëshkollor me qasje dy-gjuhësore dhe me metodën e lojës.

**3. Fondi “Ndërtojmë Ura”** fokusohet mbi stimulimin e gjenerimit proaktiv të ideve nga vet faktorët në nivel lokal, në të vërtetë komunat, shkollat dhe mësimdhënësit, bashkë me nxënësit dhe prindërit në shkolla shumë-gjuhësore ose në shkolla të vëllazëruara një-gjuhësore. Aktivitetet e stimuluar përmes Fondit lëvizin nga organizimi i ngjarjeve nga ana e komunave me përfshirjen e të gjitha shkollave të komunës dhe kështu deri në përgatitje të përbashkëta të nxënësve për ndonjë aktivitet që ka të bëjë me ndonjë nevojë ose interes nga jeta, për shembull: punëtori të TI, revy mode, set di-xhej etj. Aktivitetet i përfshijnë edhe iniciativat e mësimdhënësve, si dhe të prindërve për aktivitete jashtëshkollore.

### Dobësi të detektuar gjatë implementimit të Strategjisë

Nga aspekti i qasjes dhe pasurisë së metodologjive dhe programeve të zhvilluara, parashtrahet pyetja se sa në atë proces, në mënyrë kreative dhe burimore, janë përfshirë prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit, dhe në ç'masë ky proces në realitet është vetëm edhe një ind i formuar didaktik jashtë nga pjesëmarrja e target grupeve. Përfundimisht, kjo qasje a e shkurton lirinë ose në ç'masë lejon ndërmarrjen burimore dhe spontane të iniciativave të cilat do të ndiheshin, propozoheshin ose do të krijoheshin nga bashkësia, që në atë mënyrë të rritet besimi dhe të vetë-stimulohet përpjekja dhe përgjegjësia për një integrim më të madh?

Në mënyrë që të krijohet një mjedis mbështetës, Strategjisë së Arsimit të Integruar i mungon strategji e formuar për komunikim, të cilës do t'i detyrohen të gjithë protagonistët e nivelit nacional dhe veçanërisht ato të nivelit qendror, Kryeministri dhe Nënkrjetari i Qeverisë për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Strategjia e këtillë do të ishte një udhëzues dhe konstant inkurajuese për të gjitha aktivitetet e shkollave, përfshirë këtu edhe mediat të cilat mund të kenë një ndikim të madh mbi publikun dhe prindërit. Së këtejmi, kjo do të thotë se angazhimet e përgjithshme jo që nuk do të promovohen si aktivitete por në mënyrë esenciale do të ndihmojnë në ndryshimin e vetëdijes tek publiku. Në këtë mënyrë, protagonistët, të cilët janë target grupe, përkatësisht mësimdhënësit, prindërit dhe fëmijët do të stimulohen dhe motivohen publikisht nga objektivat më të larta të prezantuara edhe përmes zërit të protagonistëve politikë.

Në Këshillat Shkollorë ka tendencë suptile të zgjidhen prindërit të cilët janë më të popullarizuar brenda bashkësisë dhe të cilët, për shkak të çështjes ekzistenciale personale, shpeshherë ndërlidhe me ndikimin partiak (më së shpeshti qeveritar). Në një situatë të këtillë, prindërit e departizuar, të cilët patën sukses të jenë pjesë e Këshillit të Shkollës në nivelin më të lartë, aty ku vendoset për çështjet e ushqimit, sigurisë, aktivitetet jashtëshkollore dhe ngjashëm, sipas rregulloreve të ndryshme janë ose së paku ka rrezik për presion nga drejtori dhe marginalizim në lidhje me idetë, sfidat ose opinionet, për shkak të sjelljes a priori defanzive të drejtorit por që edhe vet ai është dominuar me direktivë partiake. Së këtejmi, një qelizë demokratike në tentativë është prerë në rrënjë nga veprimi autentik demokratik dhe është pikëpyetje nëse prindërit do të ishin të interesuar të jenë partnerë proaktivë, duke e pasur parasysh edhe frikën ose rezignimin për veprim për shkak të presionit të përgjithshëm dominues partiak-politik.

Kontrolli i përmbajtjeve të teksteve shkollore (pika 3 e Strategjisë) nuk është vendosur përmes një procesi konsultativ jashtë bashkësisë administrative dhe akademike. Përkatësisht, nuk ekziston mënyrë sistematike për grumbullimin e vërejtjeve sipas përmbajtjeve ose qasjes sipas së cilës janë krijuar kurikulimet përmes prindërve të nxënësve. Për fat të keq, kjo qasje kthyes nga poshtë-lartë has në barriera të cilat mund të jenë nga ato të natyrës burokratike e deri te ato partiake-politike, ndërkaq vërejtjet mund t'u dedikohen pikërisht indicieve për promovimin e dominimit të një grupi religjioz i cili ndërlidhet me etnikumin si në tekstin shkollor "Etika e religjioneve", stili i të cilit gjatë dërgimit të mesazheve është kontrovers sa i përket shekullarizimit apo sugjeron gjykimin e filozofisë si mënyrë e gabuar e sjelljes në raport me religjionin.

Dobësitë sistematike dhe strukturore, të cilat plotësohen me dobësitë motivuese, janë pengesat kryesore të identifikuara për zbatimin e suksesshëm të programeve ekzistuese. Këto programe, përveç që "vuajnë" për shkak të centralizimit dhe formalizimit tejet të madh, në mënyrë plotësuese rëndohen me pranimin jokritik të ndarjeve etnike. Kjo manifestohet edhe në pjesën më të madhe të aktiviteteve të propozuara, të cilat bëjnë përpjekje që disi t'i bashkojnë dhe përafrojnë bashkësitë e ndara, në vend që të bëjnë përpjekje për të ndërtuar bashkësi funksionale. Prandaj, qasjes i rrekemi nga një perspektivë tjetër.

### **Çështje/hipoteza kryesore**

Ekipi hulumtues supozon se integrimi i nxënësve dhe bashkësive në të cilat jetojnë do të rritet nëse bazohen në parimet inkluzive të zbatuara në praktikë, pa i potencuar kategoritë e politizuara të diferencimit social.

Presupozohet se çështjet ekologjike, sociale dhe çështjet e inkluzionit shoqëror janë më të fuqishme sesa ndarjet etnopolitike. Përmes praktikës, me informata të drejtpërdrejta për dimensionet e mirëfillta dhe reale të problemeve kryesore shoqërore dhe rolit të pjesës personale për të mirën e përbashkët, do të izoloheshin manipulimet dhe ndikimet politike dhe do të mundësohej zhvillimi i kulturës së inkluzivitetit, e jo të ndarjes dhe raporteve hierarkike shoqërore.

Çështja kryesore është – si të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive këto aktivitete jashtëshkollore? Tri kategori të protagonistëve janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë dhe për përfshirjen e secilit prej tyre duhet të gjendet përgjigjja e saktë: 1) si të stimulohen pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë - nxënësit; 2) si të motivohen faktorët kryesorë dhe përgjegjës - mësimmhënësit; dhe 3) si të merret pëlqimi dhe interesimi i prindërve?

Që të arrihet deri te pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë, është e domosdoshme të merret pëlqimi nga përgjegjësit e procesit arsimor, ndërsa ato janë organet drejtuese të shkollave, personat përgjegjës të komunave dhe BZHA dhe MASH. Si t'i qasemi justifikimit të synimeve, karakterit dhe shtrirjes së aktiviteteve jashtëshkollore në mënyrë që të fitohet aprovimi i domosdoshëm?

## Metodologjia

jatë hulumtimit përdorëm disa qasje të hulumtimit:

- Për analizën e gjendjeve dhe kushteve të përgjithshme e analizuar kornizën ekzistuese ligjore.
- Në mënyrë të veçantë u hulumtuan më shumë praktika aktive në fushën e arsimit, të cilat kanë për qëllim arsimin e integruar.
- Përveç përdorimit të burimeve sekondare të informatave, siç janë ligjet dhe raportet, gjithashtu anëtarët e ekipit zhvilluan intervista me protagonistët e involvuar, të cilët i zbatojnë këto programe.
- Në mënyrë plotësuese, u realizuan një sërë intervistash gjysmë – të strukturuar në katër qytete të Maqedonisë: Kumanovë, Tetovë, Veles dhe Dojran.

## Analiza

Analiza e të dhënave të mbledhura, para së gjithash, bazohet në pjesën e përvojës së atyre të cilët i zbatojnë programet e lartpërmendura. Para se t'i pranojmë dhe përpunojmë të dhënat e pranuar për sistemin e arsimit dhe llojet e ndryshme të programeve të zbatuara institucionale, të cilat duhej të çonin në arsimin inkluziv, dhe jo siç quhet – mbase gabimisht – arsim i integruar, përpiluan Pyetësor i cili më pas shërbeu për një sërë intervistash në shkolla. Vetëm shkurtimisht do t'i përmendim edhe një herë konkluzionet kryesore për programet e zbatuara dhe më pas do të kalojmë në analizën e hulumtimit tonë në teren.

### **Konkluzione për zbatimin e disa programeve për arsimin e integruar në Republikën e Maqedonisë përmes burimeve sekondare dhe raporteve të publikuara**

Shqetëson fakti se, edhe pas 5 vitesh përpjekje për implementimin e Strategjisë për Arsimin e Integruar, përmes projekteve nga të cilët më të rëndësishëm janë NMIE (Nansen Model for Integrated Education) dhe PINA - Projekt i USAID për Integrimin Ndëretnik në Arsim, si dhe Fondi “Ndërtojmë Ura”, në vend të hapërimit drejt avancimit të evaluimit të projekteve, vërehet se gjendja ose stagnon ose shënon regres.

Hallkë e dobët e këtij procesi janë instancat e nivelit lokal, përkatësisht komunat të cilat nuk kanë kapacitete për ndikim më esencial dhe të pritshëm, duke i marrë parasysh kompetencat të cilat i kanë përmes procesit të decentralizimit.

MASH si institucion qendror nacional, e cila e koordinon këtë proces, krahas përpjekjeve konstruktive me partnerët ndërkombëtarë në nivel konceptual në procesin e implementimit, në të shumtën e rasteve nuk ofron mbështetje të mjaftueshme ose përmes mbulimit financiar të pamjaftueshëm apo përmes mungesës së mirëkuptimit për nevojat i forcon ingerencat mbikëqyrëse dhe ndëshkuese ndaj shkollave/mësimdhënësve dhe shumë pak ose aspak, absorbon informacione nga faktorët e nivelit lokal (mësimdhënës dhe këshilla të prindërve).

Kjo strukturë organizative dhe transparenca e pamjaftueshme për problemet e shfaqura në praktikë, të cilat nënkuptojnë se disa koncepte ose qasje të caktuara të MASH ose të komunave duhet të përshtaten, shkakton rezistencë midis kuadrit mësimdhënës dhe demotivim të plotë të involvimit thelbësor gjatë realizimit të synimeve strategjike. Me këtë, investimi i plotë përmes transferimit të njohurive dhe aftësive ndaj mësimdhënësve shpie deri në realizimin e dobët ose deri në përmbushjen e pamjaftueshme të synimeve të përcaktuara të Strategjisë, ose nga ana tjetër ka të bëjë me listën e kontrollit teknik.

Aktivitetet jashtëshkollore, të cilat në fakt duhet por edhe përmbajnë elemente jo aq arsimore sa edukative, sipas natyrës së tyre duhet të jenë një proces kooperativ në të cilin prindërit kanë përfshirje të qartë, ndërsa procesi i pranimit dhe praktikimit të vlerave eksternizohet në, dhe përmes familjes.

Së këtëjmi, mungesa ose përkujdesja e pamjaftueshme dhe procedura të konceptuara me përkushtim, veçanërisht nga ana e autoriteteve komunale për jetësimin dhe funksionimin e mirëfillt të bashkëpunimit me prindërit përmes këshillave shkollorë është "Thembra e Akilit" për ndërtimin esencial të integritetit në nivel të bashkësisë.

Këshillave shkollorë, si mekanizma të ri dhe të brishtë demokratik, në realitet shpeshherë u mungon vizioni për rolin e tyre në jetën shkollore. Shumë shpesh, këta këshilla uzurpohen nga ngjarjet ditore-politike në nivel nacional dhe të administruar në mënyrë subjektive sipas parimit të frikës, e që shpesh ndikon edhe në përbërjen e prindërve dhe përkatësinë e tyre partiake në sfond ose simpati të supozuar partiake. Në këtë mënyrë pengohet potenciali kreativ dhe qarkullimi i ekspresionit proaktiv të lirë, i cili në masë të madhe mund ta mbështesë procesin edukativ të nxënësve.

Në këtë seksion e trajtuam strukturën sistematike dhe organizative të procesit mësimor, si dhe programet të cilët e targetojnë tejkalimin e segregacionit të hasur arsimor dhe rrjedhimisht me këtë segregacionit shoqëror. I identifikojmë pikat e dobëta me qëllim të tejkalimit të tyre në programet e ardhshme. Tani do t'i bëjmë një vështrim përvojave të zbatuesve të drejtpërdrejtë të këtyre programeve dhe opinionit të tyre për procesin e përgjithshëm dhe efektet e programeve, si dhe opinionet e tyre për programe më efektive.

### **Konkluzione të bazuara në përgjigjet e pyetësorit të zbatuar në terren**

Këto konkluzione janë përpiluar mbi bazë të hulumtimit të zbatuar në terren, me ç'rast u përfshinë katër qytete. Intervistat, të cilat janë bashkëngjitur ndaj studimit janë realizuar me mësimdhënësit e shkollave filllore në: Veles, Kumanovë, Tetovë dhe Dojran. Informatat nga shkollat filllore të Tetovës janë marrë nga bisedat dhe intervistat e realizuara me nga dy mësimdhënësve nga shkolla të ndryshme filllore, njësoj sikurse në Kumanovë, ndërsa në Veles dhe Dojran në intervista morën pjesë nga një mësimdhënës të arsimit fillor. Të gjitha shkollat, në të cilat punojnë mësimdhënëset të cilat janë pjesë të intervistave, janë me përbërje të përzier etnike. Radhitja e analizës e ndjek radhitjen e pyetjeve të parashtruara gjatë intervistës, ndërsa konkluzionet janë përpiluar sipas përgjigjeve të sublimuara nga mësimdhënësit e anketuar.



1. Si është komunikimi midis nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike në shkollë?

Kësaj pyetje, mësimdhënësit të cilët ishin pjesë e hulumtimit nga tre qytete: Veles, Kumanovë dhe Tetovë, kanë dhënë përgjigje identike. Shkolla e Tetovës procesin mësimor e zhvillon në tri gjuhë: maqedonisht, shqip dhe turqisht, ndërsa komunikimi është në nivel të lakmueshëm. Në Kumanovë, bashkëpunëtorë ishin mësimdhënësit nga dy shkolla të ndryshme, prej të cilave tek njëra mësimi zhvillohej në gjuhën maqedonase dhe kishte nxënës të nacionalitetit maqedonas, serbë dhe romë, ndërsa tek shkolla tjetër, në të cilën gjithashtu mësojnë romë dhe serbë, kishte edhe shqiptarë, por në asnjërin shkollë nuk u vërejt jotoleranca, incidente dhe përplasje. Komunikimi dhe bashkëpunimi zhvillohen krejtësisht në mënyrë normale. Situata është e njëjtë edhe në Veles. Në këtë hulumtim është shtuar edhe një shkollë nga Dojrani, meqë edhe kjo komunë ka përbërje të përzier etnike. Po ashtu, komunikimi midis nxënësve në Dojran është i shkëlqyer.

2. A ka forma dhe lloje të bashkëpunimit dhe aktiviteteve të përbashkëta? Cilat janë ato dhe në çfarë përmasash?

Në Tetovë gjatë procesit mësimor, por edhe gjatë aktiviteteve jashtëshkollore realizohen punëtori të përbashkëta midis nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike. Këto punëtori u nxitën përmes realizimit të Projektit: "Integrimi ndëretnik në arsim". Megjithatë, meqë të njëjtat kërkojnë përgatitje të madhe nga ana e mësimdhënësit, angazhim të madh, shumë materiale dhe bashkëpunim me prindërit, të njëjtat realizohen më shumë në klasat e ciklit të ulët sesa të ciklit lartë. Kjo, më së shumti varet nga vet mësimdhënësit – ata të cilët vazhdimisht punojnë dhe janë në hap me risitë e proceseve edukative-arsimore, me kënaqësi e realizojnë edhe këtë Projekt. Në Kumanovë implementohet Projekti për integrimin ndëretnik, i cili është iniciuar nga Ministria e Arsimit dhe i cili nënkupton bashkëpunim me shkollat me mësim në gjuhën shqipe. Bashkëpunim të përbashkët midis shqiptarëve dhe maqedonasve ka në rastet kur realizohen projekte të ndryshme për bashkëpunim të ndërsjellë, ndërkaq edhe mësimdhënësit këtë vit filluan të zhvillojnë edhe nga një orë të përbashkët mësimi. Ndonjëherë ka edhe gara të përbashkëta sportive. Gjatë këtij viti, në suaza të Projektit për integrim ndëretnik është financuar seksioni me karakter multietnik. Ky seksion është për gjuhë angleze dhe atë e zhvillojnë 3 mësimdhënësit të gjuhës angleze të cilat janë maqedonase, një mësimdhënëse shqiptare dhe një mësimdhënëse shqiptar. Janë përfshirë edhe nxënës të klasës së katër dhe më lart dhe vërehet interesim i madh për aktivitetet e këtilla, fëmijët bashkëpunojnë pa problem mes vete dhe dëshirojnë të shoqërohen. Gjendja është e njëjtë edhe në Veles dhe Dojran, ku të gjitha aktivitetet zhvillohen bashkërisht.

3. A mjafton kjo për t'u siguruar kontakt i mjaftueshëm, njohje, shoqërim, bashkëpunim dhe tejkallim të hendekut etnik?

Qëndrim i përgjithshëm i mësimdhënësit për Projektin, i cili është iniciuar nga MASH është se nuk është i mjaftueshëm, për arsye se përfshinë 2 deri 3 aktivitete në gjashtë muaj dhe nuk është i mjaftueshëm që të tejkalohet hendeku ndëretnik. Nga Projekti është i dobishëm seksioni i cili bashkon përmes gjuhës së tretë dhe nevojitet rritja e numrit të aktiviteteve. Gjithashtu, duhet të merret parasysh informacioni se nxënësit e shkollave të fshatrave: Buzalkovë, Klukovec dhe Slivnik të cilat janë me popullsi shqiptare, ndërkaq i takojnë Komunës së Velesit, nuk përzihen me nxënësit maqedonas dhe për ta nevojitet angazhim më i madh në kuadër të këtij Projekti

4. A u kushtohet vëmendje e posaçme pyetjeve për bashkëjetesë dhe si zhvillohet kjo në praktikë?

Edhe pse në Programin vjetor të punës në disa shkolla janë parashikuar aktivitete lidhur me bashkëjetesën, ekziston mungesë e vazhdimësisë së aktiviteteve të këtilla në mënyrë që të arrihet efekti. Në kuadër të orës së kujdestarisë ka lëndë: "Aftësi jetësore" përmes së cilës realizohen punëtori nga fusha të ndryshme të jetës, madje edhe tema për bashkëjetesë. Masa të posaçme nuk ka, përveç që mësimdhënësit sugjerojnë dhe veprojnë në mënyrë edukative sa i përket bashkëjetesës midis bashkësive të ndryshme etnike. Në Dojran është praktikë të vizitohen mes vete gjatë festave fetare dhe festave familjare, siç janë dasmat, pagëzimet dhe sytnet.

5. A mendoni se do të mund të iniciohej programi/aktiviteti jashtëshkollor, i cili do t'i bashkonte dhe afronte fëmijët e përkatësive të ndryshme etnike, e që është interes i përbashkët. Këto aktivitete nuk do të jenë të imponuara “masa për përmirësimin e bashkëjetesës dhe tolerancës ndëretnike”, por do të zgjidhen nga vet nxënësit, bashkë me mësimitdhënësit dhe në konsultim me prindërit.

Në intervistat u parashtrua propozim-ideja që programi/aktiviteti jashtëshkollor të mos futet si aktivitet i veçantë, por si lëndë zgjedhore plotësuese për shkak të rezistencës së mësimitdhënësve ndaj numrit të madh të ndryshimeve në arsim. Nëse futet si lëndë zgjedhore, të hiqen fjalët “bashkëjetesë”, “tolerancë” dhe ngjashëm, por lënda t'i përmbajë të gjitha këto komponentë dhe të ketë titull i cili do t'i tërheqë edhe prindërit edhe fëmijët. Është specifikuar se një aktivitet i këtillë ekziston, më saktësisht në Projektin e MASH, të cilin tanimë e kemi përmendur. Është manifestuar dyshimi se në Kumanovë a do të mund të zbatohet programi/aktiviteti jashtëshkollor për përafrimin e fëmijëve të përkatësive të ndryshme etnike, për shkak të veprimeve të fundit luftarake të muajit maj 2015, të cilat kontribuuan për rritjen e mosbesimit ndëretnik. Gjithashtu, ndikon edhe fakti se prindërit e një numri të konsiderueshëm të nxënësve janë pjesëtarë të forcave të sigurisë së RM-së dhe se mjedisi në shoqëri është konservativ, kështu që do të shfaqeshin pengesa nga ana e prindërve për realizimin e aktivitetit të këtillë. Ekzistojnë aktivitete si eko-patrulla, mbjellja e pemëve, ndërkohë që mund të realizohet edhe diçka plotësuese me kërkesë të fëmijëve. Në Veles ekziston interesim dhe nevojë për realizimin e aktivitetit jashtëshkollor.

6. A është e realizueshme kjo? Çka do ta parandalonte dhe çka do të shkaktonte problem dhe pse? Çka do të ishte pranuar pozitivisht dhe pse?

Problem gjatë realizimit të llojeve të këtylla të projekteve është fakti se bartës i projektit është një mësimitdhënës dhe e gjithë përgjegjësia dhe realizimi bie mbi të/te, gjithashtu ai mësimitdhënës është përgjegjës edhe për projektet e tjera në shkollë. Do të ishte e dobishme nëse llojet e këtylla të projekteve do të fillonin të realizoheshin në më shumë shkolla në shtet. Përfitimet do të shiheshin pas një viti, pasi që të formohet ekipi i mësimitdhënësve, do të vërehej angazhim më i madh i nxënësve, do të angazhoheshin edhe nxënësit të cilët janë problematikë, nxënësit me aftësi të kufizuara, gjithashtu edhe prindërit. Në një shkollë të Kumanovës ka seksion për gjuhë angleze, i cili rezulton nga një projekt dhe të cilin e drejton një mësimitdhënës, megjithatë ai bashkëpunon edhe me mësimitdhënës të tjerë. Ky seksion ka sukses për shkak të interesimit të nxënësve për gjuhën, dhe është i mendimit se mund të formohen edhe seksione të lëndëve të tjera, por iniciativa duhet të burojë nga kuadri mësimitdhënës, nxënësit ose drejtori. Në Veles është vërejtur mungesë e mjeteve financiare, problemi me kohën për shkak të mbingarkimit të programeve dhe planeve mësimore, si dhe Kembrixh Programi për grupin e lëndëve të shkencave të natyrës. Po ashtu, ka mungesë motivacioni, përveç asaj etike dhe morale, dhe kjo mungesë është vërejtur tek një pjesë e madhe e të punësuarve, si dhe tek prindërit. Fëmijët do ta mirëprisnin çdo lloj aktiviteti i cili rezulton nga kuadri i detyrave të përditshme.

7. Si të realizohet?

Nevojitet një ekip i mirë, përpilimi i planit të veprimit për secilën shkollë veç e veç, intervenim mbi aktin juridik nga niveli më i lartë dhe koordinator nga jashtë (BZHA dhe MASH)/ gjithashtu, është shprehur dyshimi se nuk mund të realizohet nëse nuk ka imponim nga Ministria. Në Dojran fëmijëve u jepen ide për punë të përbashkët dhe u lihet hapësirë, përmes votimit, që vetë ta bëjnë përzgjedhjen se cilin aktivitet do ta realizojnë, me pjesëmarrjen e bashkësive tjera etnike dhe duke theksuar se në këtë mënyrë do të mësojnë diçka të re. Në Veles, rregullisht për Vitin e Ri organizohen aksione takimi në hollin e shkollës dhe përgatiten dhurata për nxënësit e kategorive sociale vulnerable. Rregullisht mbahen takime për plastikë të vjetër, bateri dhe letër dhe bëhet seleksionimi i mbeturinave.

8. Kush duhet të përfshihet për realizimin më të suksesshëm të kësaj iniciative?

Një ekip i mirë i mësimdhënësve nga lëndë të ndryshme mësimore, prindër aktivë, nxënës dhe përfaqësues i komunës, MASH dhe BZHA, si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe biznes grupacionit.

9. Sa janë të lirë mësimdhënësit për të propozuar dhe realizuar programe jashtëshkollore?

Mësimdhënësit kanë liri të plotë për të propozuar programe jashtëshkollore, megjithatë vështirësi mund të paraqiten gjatë realizimit, për shkak të mbingarkimit të nxënësve, meqë fëmijët madje kanë nga 6 orë mësim në ditë. Është e nevojshme të informohet Inspektorati i Arsimit dhe pa pëlqimin e prindërve dhe MASH, nuk ka mundësi të ndërmerren aktivitete të këtilla jashtë kornizës ligjore. Propozimet doemos duhet të jenë në përputhje me rregulloret e përpiluara nga BZHA dhe MASH.

10. Cili është interesimi dhe përgjigjja e prindërve të cilët janë anëtarë të këshillave të shkollës?

Jo vetëm prindërit të cilët janë anëtarë të Këshillit të shkollës, por edhe prindërit e tjerë janë të përfshirë në aktivitetet mësimore jashtëshkollore në klasat ku mësojnë fëmijët e tyre. Megjithatë, përfshirja e tyre varet shumë edhe nga mësimdhënësi i cili i planifikon aktivitetet dhe përfshirjen e prindërve në to.

11. Deri më tani a u ka ndodhur mësimdhënësve dhe prindërve të propozojnë program jashtëshkollor dhe i njëjti të jetë refuzuar nga institucionet kompetente (BZHA, MASH)? Nëse u ka ndodhur, si ka qenë ai program?

Nuk ka ndodhur të propozohet program jashtëshkollor nga shkolla dhe t'u jetë refuzuar nga ana e institucioneve kompetente. Megjithatë, ekziston një numër i vogël i aktiviteteve jashtëshkollore të cilat janë propozuar nga ana e shkollës, meqë kryesisht prindërit japin propozime. Por, nëse nuk janë në përputhje me kuadrin nënligjor, nuk do të pranohen.

12. Cilët janë propozimet e mësimdhënësve dhe prindërve për realizim më të lehtë dhe më të lirshëm të aktiviteteve/programeve jashtëshkollore?

Varësisht nga kushtet, do të realizoheshin pas mësimit, dy herë në javë. Është propozuar të realizohen në çdo të shtunë të parë të muajit ose në dy të shtuna në muaj, në mënyrë që të angazhohen më shumë mendërisht, si dhe më pak t'i përdorin smartfonët dhe të luajnë video-lojëra. Propozimet e mësimdhënësve dhe prindërve variojnë nga komuna në komunë. Përderisa në Kumanovë propozimet për aktivitetet jashtëshkollore janë të rralla, në Dojran prindërit i mbështesin këto aktivitete dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në to, ndërsa në Veles nuk ekzistojnë fare.

13. Sa është problem mungesa e mjeteve financiare në realizimin e programeve jashtëshkollore: si mund të tejkalohet i njëjti?

Do të ishte mirë si stimulim t'u jepen pikë mësimdhënësve, të cilët do të angazhohen në këto aktivitete. Mungesa e mjeteve financiare është problem i madh, ndërsa sponsorizimi nga biznes komuniteti dhe komuna do të ishin të dobishme. Në Kumanovë seksioni i gjuhës angleze ka pasur mjete në lartësi prej 20 mijë denarë, por mjetet nuk kishin arritur deri në fillimin e aktiviteteve, kështu që ato i kanë realizuar me shpenzime vetjake. Kanë organizuar maskeball të "Natës së Shtrigave" në të cilin kanë marrë pjesë 200 fëmijë dhe kanë qenë të pranishëm edhe mësimdhënësit dhe prindërit. Çmimet janë financuar vetëm nga drejtori, ndërsa shpenzimet e tjera i kanë mbuluar vet. Me rëndësi kryesore është dëshira dhe motivimi. Gjithashtu, nevojitet edhe angazhim më i madh i komunave dhe liri më e madhe e shkollave sa u përket mjeteve të disponueshme nga burime vetjake, si dhënia me qira e sallës sportive.

Vendosëm t'i prezantojmë opinionet e mësimdhënësve në një formë sa më të drejtpërdrejtë të mundshme, me qëllim që t'u mundësojmë, si aktorë më të thirrur dhe më të ekspozuar në procesin arsimor, ta shprehin mendimin e tyre. Në kombinim me analizat tona të sistemit të arsimit dhe përshtatjen e tij në shoqërori, praktikat ekzistuese dhe përpjekjet për arsim të integruar, si dhe informatat tona nga terreni e ndërtojmë propozim politikën përfundimtare për arsimin e integruar, përkatësisht për arsimin inkluziv.

## Konkluzione

Është evidente se zbatimi i programeve të imponuara institucionale për integrimin e nxënësve me prejardhje të ndryshme etnike në një sistem i cili çon në mjedise etnike arsimore të segreguara has në një sërë vështirësish të cilat, para së gjithash, janë formale ligjore, organizative por edhe të natyrës motivuese. Gjatë shqyrtimit të kornizës ligjore ekzistuese, literaturës dhe përcaktimit të gjendjes faktike përmes një sërë intervistash dhe analizash të programeve për zbatimin e Strategjisë për Arsimin e Integruar u vërejtën një varg dobësish strukturore dhe sistematike. Këto dobësi doemos duhet të tejkalohen, në mënyrë që të mundësohet integrim i mirëfilltë dhe jo vetëm deklarativ i shoqërisë. Nga dobësitë strukturore veçohet arsimi i segreguar. Vetëm në një të dhjetat e shkollave mundësohet kontakti i drejtpërdrejtë midis nxënësve të bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare. Kjo, në mënyrë të drejtpërdrejtë, vë në dukje domosdoshmërinë e gjetjes së aktiviteteve të përbashkëta, të cilat do t'i bashkonin dhe do t'u mundësonin kontakt këtyre fëmijëve, mësimsdhënësve dhe prindërve të tyre, nëse dëshirohet të krijohet një shoqëri funksionale e përbashkët shoqërore. Nga dobësitë sistematike, gjithashtu veçohet centralizimi i madh dhe varësia e shkollave edhe atë si nga aspekti financiar, ashtu edhe nga aspekti përmbajtësor, nga autoritetet qendrore. Në sistem parashikohet njëfarë lirie e aktiviteteve jashtëshkollore, megjithatë, ai përsëri duhet të aprovohet nga instancat më të larta menaxhuese.

Në analizën e gjendjeve u konfirmuan supozimet tona se është e domosdoshme të ketë një qasje nga perspektivë tjetër, përkatësisht të ofrohet një atmosferë e natyrshme, lehtësuese pa imponime, në të cilën me vetëdashje dhe me vetiniciativë do të organizohen aktivitete jashtëshkollore, të cilat do ta fisnikërojnë dhe plotësojnë procesin edukativ-arsimor dhe do të çojnë deri në rritjen e inkluzivitetit. Inkluziviteti, për të cilin angazhohemi, nuk ka bëjë me tejkalimin e hendeqeve etnike, por me perceptimin e inkluzivitetit në mënyrë të përgjithshme dhe më humane të ndërtimit të bashkësive sociale, klasore, të vetëdijesuara shoqërore, të cilat vërtetë në mënyrë aktive do t'i përfshijnë të gjithë faktorët – prindërit dhe nxënësit dhe kuadrin profesionistë dhe mësimor të shkollave. Së këtejmi, në qoftë se nuk bëhet fjalë për tejkalimin e dallimeve statusore, të përbërë nga diversitetet klasore dhe kulturore, të cilët koincidojnë me ndarje etnike, vështirë se do të fitohet bashkësi e integruar.

Atë që e ofrojmë si temë dhe fushë të organizimit të aktiviteteve jashtëshkollore, njëherësh është edhe stimulim motivues për aktivizimin e pjesëmarrësve në procesin arsimor, të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Para së gjithash, është i domosdoshëm sensibilizimi i publikut të interesuar, ose target grupeve, për çështjet me interes të përgjithshëm shoqëror. Stimulimi i ndërgjegjësimit ekologjik, përmes programeve për seleksionimin primar të mbeturinave nëpër shkolla dhe shtëpi, prodhimi vetjak i ushqimit organik në kopshte të shkollave ose lokale, gatimi i përbashkët, janë programe të cilët do t'i përfshinin dhe angazhonin nxënësit, mësimsdhënësit dhe prindërit. Pastaj, programet për arsimin inkluziv siç janë: ndërtimi i rampave për personat me aftësi të kufizuara, si në shkolla ashtu edhe në bashkësi, ofrimi i mundësive të barabarta për arsimin e bashkëmoshatarëve të kategorive sociale vulnerabile, siç është sigurimi i teksteve shkollore dhe mjeteve ndihmëse shkollore, transporti dhe ngjashëm, gjithashtu do t'i përfshinin të gjitha target grupet dhe do të mundësonin veprim mbi-etnik dhe krijimin e bashkësisë inkluzive. Përfundimisht, programet të cilët do të dilnin jashtë oborrit të shkollës dhe të të angazhoheshin për zgjidhjen e problemeve të natyrës sociale dhe shoqërore në bashkësinë më të gjerë, siç mund të jenë organizimet e grupeve për ndihmë, shoqërimi dhe socializmin e të moshuarve, personave të pamundur dhe të vetmuar ose organizimin e kuzhinave popullore dhe ofrimin e ndihmës për kategoritë e bashkëqytetarëve më vulnerabil, përsëri do të rezultojnë me integrim të rritur të bashkësisë.

Më e rëndësishmja është se këto programe dhe aktivitete nuk do të imponohen dhe diktohen, si përmbajtje dhe programe të cilat doemos duhet të evaluohen para organeve kompetente, por do të ishin programe të përzgjedhura drejtpërsëdrejti nga vet nxënësit, me aprovimin dhe nën udhëheqjen e mësimitdhënësve të tyre, si dhe këshillave dhe ndihmës nga prindërit e tyre. Përfshirja e këtyllë mbi bazë vullnetare do t'i referohej nxënësve dhe prindërve, ndërsa pjesa e mësimitdhënësve gjithsesi se do të duhej të valorizohej në mënyrë përkatëse për punën dhe kohën shtesë. Evitimi i profesionalizimit dhe institucionalizimit, edhe pse në kuadër të zgjidhjeve ligjore sistemore, do ta nxitë dhe zhvillojë vetëdijen për veprim të përbashkët dhe ndërtim të një bashkësi shoqërore të hapur dhe të përgjegjshme në të cilën bartësit e ardhshëm do të rriten si individë të ndërgjegjshëm, të fuqishëm dhe me vetëbesim, të sigurt dhe të patrembur nga konstruksionet politike të Tjetrit dhe të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e ndihmës së ndërsjellë dhe vetorganizimit.

***Në mënyrë që të kompletohen këto konkluzione i shtojmë rekomandimet si vijojnë:***

***Rekomandime:***

- Sistemi arsimor shumë i centralizuar dhe kontrolli mbi shkollat doemos duhet të lejojë shkallë më të lartë të lirisë dhe mbështetjes për iniciativat nga poshtë-lartë në aktivitetet jashtëshkollore. Kjo do ta mundësojë zhvillimin e bashkësisë inkluzive dhe koherente, në vend të refleksionit të rëndomtë të ndarjeve etnopolitike, të cilat janë të pranishme në shoqëri.
- Procedurat burokratike dhe administrative, të cilat i rregullojnë çështjet e organizimit të aktiviteteve jashtëshkollore doemos duhet të thjeshtëzohen. Rregullorja për metodat e realizimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit e arsimit fillor, varet shumë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kjo procedurë duhet të jetë më e lehtë në mënyrë që ta hap rrugën e komunikimit më pak të formalizuar, ndërkaq kujdesi për sigurinë mbetet primar.
- Qasja mbi-etnike dhe mbi-nacionale në aktivitetet jashtëshkollore të stimulohet përmes angazhimit me temat të cilat ua mësyjnë ndarjeve të bazuara mbi përkatësinë. Aktivitetet që kanë të bëjnë me fushat dhe temat universale, si mjedisi jetësor dhe inkluzioni social, të cilat e potencojnë solidaritetin dhe empatinë, doemos duhet ta kenë vendin e qasjes aktuale “integruese” e cila i esencializon ndarjet etnike.
- Doemos duhet të ekzistojë transparencë për idetë, të cilat momentalisht nuk stimulohen nga korniza etno-politike, e cila e formëson shoqërinë maqedonase. Doemos duhet të ketë më shumë hapësirë për përfshirjen e bashkëpunimit me aktorët e tjerë të Shoqërisë civile në komunë, të stimuluar nga vet komuna, si: organizata të vëzhguesve, organizata të profesionistëve sportiv, organizata të artistëve, organizatave të mjedisit jetësor dhe ngjashëm. Procesi i miratimit të vendimeve, megjithatë duhet të jetë i stimuluar në aspekt kreativ përmes diskutimeve në kuadër të këshillave shkollore/të prindërve, të cilët duhet të gjenerojnë dhe miratojnë vendime, me një moderim shumë të vogël, në atë proces nga ana e shkollës.

- Komunitetet duhet të ndërmarrin përgjegjësi më të madhe në procesin arsimor dhe seriozisht të angazhohen në aktivitetet jashtëshkollore, si një nga rrugët më të qëndrueshme drejt zhvillimit të bashkësisë më inkluzive në nivel lokal.
- Komunitetet duhet ta braktisin rolin e distributorit të bllok dotacioneve nga pushteti qendror dhe të bëhen faktorë proaktiv në financimin dhe stimulimin e aktiviteteve inkluzive jashtëshkollore. Një shumë e caktuar e buxhetit doemos duhet të fokusohet në aktivitetet jashtëshkollore inkluzive nga poshtë-lartë dhe një numër i caktuar i aktiviteteve duhet të implementohen nga çdo shkollë.
- Marrë në përgjithësi, rekomandojmë qasje krejtësisht të ndryshme ndaj njësive të cilat në mënyrë demokratike marrin vendime në nivel të shkollës. Trekëndëshi mësimdhënës-prindër-nxënës është i pranishëm në mënyrë strukturore, por në praktikë është joefikas dhe jothelbësor. Posaçërisht Këshilli i Prindërve duhet të ketë liri më të madhe në krijimin e ideve të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet e lira jashtëshkollore, me udhëheqje minimale të ideve nga ana e kuadrit mësimor të shkollës, përkatësisht mësimdhënësve. Në këto procese, doemos duhet të përfshihen nxënësit edhe atë nga fillimi e deri në të gjitha fazat.
- Duhet të implementohen përpjekje serioze në mënyrë që të theksohet rëndësia e ekzistimit të Këshillit të Prindërve. Ai duhet të jetë perceptohet si një mekanizëm demokratik për vendimmarrje participative në sistemin e arsimit dhe të mos trajtohet për nevoja komerciale që kanë të bëjnë me hotelerinë dhe sigurimin e shkollave në kuadër të procedurave të tenderëve.
- Për këtë qëllim, në mënyrë që të tejkalohet mungesa e besimit nga ana e prindërve lidhur me punët të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet ndëretnike, duhet të ketë inkluzion progresiv të prindërve në procesin e marrjes së vendimeve, i cili do të zbatohet përmes ndryshimeve të legjislacionit në kuadër të Rregullores për metodën e zbatimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore dhe të implementohet me vëmendje më të madhe nga kuadri relevant i komunës, i cili e bën monitorimin dhe nga drejtori i shkollës.
- Në kuadër të Rregullores për metodën e zbatimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore, hapësirë më e madhe duhet t'i jepet iniciativave të cilat vijnë nga nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, në vend të vendimeve paraprakisht të miratuara të cilat vijnë nga lartë-poshtë.
- Revizioni i listës së vendeve të aprovuara dhe monumenteve të cilat mund të vizitohen. Përzgjedhja e vendeve të aprovuara dhe monumenteve të cilat mund të vizitohen gjatë organizimit të aktiviteteve jashtëshkollore dhe udhëtimeve/ekskursioneve duhet të rishikohen në mënyrë kritike dhe të balancuar me qasje shekullore e cila duhet të respektohet në kuadër të procesit arsimor.
- Të përcaktohet më mirë roli i asistentëve të drejtorëve në shkollat fillore. Ata duhet të jenë garantues të autonomisë së procesit të miratimit të vendimeve në kuadër të këshillave shkollore. Në mënyrë më precize të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike në bashkësitë në nivel komunal.

## Burime të përdorura

### Bibliografia

Barbieri, S., Vrgova, R., Bliznakovski, J., 2013, Tejkalimi i segregacionit etnik: si të integrohen shkollat në Maqedoni dhe Bosnje e Hercegovinë, Pse Jo, Sarajevë dhe Instituti i Demokracisë Societas Civilis, Shkup

Bodenhausen, G.V., 2010, "Diversity in the Person, Diversity in the Group: Challenges of identity complexity for social perception and social interaction", European Journal of Social Psychology, Vol. 40, pp. 1–16

Henry, P.J., Hardin, C.D., 2006, "The Contact Hypothesis Revisited: status bias on the reduction of implicit prejudice in United States and Lebanon", Psychological Science, Vol. 17, No.10, pp. 862–868

Hewstone, M., 2009, "Living Apart, Living Together: The role of intergroup contact in social integration", Proceedings of the British Academy, 162, pp. 243–300

Pettigrew, T., Tropp, L., 2006, "A Meta-Analytic Test of Intergroup Contact Theory", Journal of Personality and Social Theory, Vol. 90, No. 5, pp. 751–78

### Literaturë tjetër e përdorur

Strategjia drejt sistemit të integruar arsimor "Hapa drejt sistemit të integruar arsimor në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë", Ministria e Arsimit e Republikës së Maqedonisë

Prezantimi i Raportit: "Bridges and Divisions in Education", viti 2011, Misioni i OSBE në Republikën e Maqedonisë

### Burime nga interneti

Projekt për integrimin ndëretnik në arsim: <http://mk.pmio.mk/>

Naskova Z., Mathias K., Mihajlovic J., Popovic Valjeva M., 2014, "Midterm Evaluation report of USAID/Macedonia's Interethnic Integration in Education Project":  
[http://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PA00K15Q.pdf](http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00K15Q.pdf)

Storje gazetareske, raportim TV Menada: <https://www.youtube.com/watch?v=HjqsasGbeog>

Modeli Nansen për Arsimin e Integruar: <http://nmie.org>

Teksti shkollor "Etika e religjioneve", f. 79 dhe f. 19:  
[http://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Etika\\_vo\\_religiite\\_5\\_mak.pdf](http://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Etika_vo_religiite_5_mak.pdf)

## Ligje të konsultuara

Ligji për arsimin fillor, tekst i konsoliduar, (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015 dhe 145/2015)

Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm, tekst i konsoliduar, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 10/2015 dhe 145/2015)

Ligji për Byronë e Zhvillimit të Arsimit, tekst i konsoliduar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.37/2006; 142/2008; 148/2009, 69/2013, 120/2013, 148/2013 и 41/2014)

Ligji për vetëqeverisje lokale, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 5, viti 2002

Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61/2004)

Ligji për inspeksionin e arsimit, tekst i konsoliduar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 52/2005, 81/2008, 148/2009, 57/2010, 51/2011, 24/2013, 137/2013, 164/2013, 41/2014, 33/2015 dhe 145/2015)

Ligji për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm, tekst i konsoliduar, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014 dhe 146/2015)

Neni 34 paragrafi 4 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 103/08, 33/10, 116/110, 156/10, 18/11, 15/11, 6/12, 100/12, 24/13 dhe 41/14), Rregullore për mënyrën e zbatimit të ekskursioneve shkollore dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore